



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 06/01-8989 2026
Kaçanik, 17.04.2026

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e IV(katërt) të rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, për vitin 2026.

Mbledhja do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 30.04 2026 (e enjte) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq, Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!



Kryesuesi i Kuvendit
Selajdin Troni

Në mbledhjen e IV (katërt) të rregullt të Kuvendit të Komunës, të datës 30.04.2026, do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti tremujor financiar për periudhën: Janar-Mars 2026;
3. Propozim Vendim për themelimin e Komisionit komunal të aksionarëve për NPK “Stacioni i Autobusave” SH.A.- Kaçanik;
4. Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK Kaçanik i Vjetër.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr.060/01-6490/2026
Kaçanik, 30.03.2026

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **III (tretë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2026 (Legjislatura e 8), mbajtur me 30.03.2026 (e hënë), në katin e tretë, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës në mbledhje fillimisht u konstatua se janë 20 anëtarë, në ndërkohë arriti Betim Shala, kështu që pjesëmarrës janë 21 anëtarë-të gjithë. Nga Ekzekutivi i komunës morën pjesë: Kryetari i Komunës-Sabedin Vishi, Nënkryetari i Komunës -Xhelal Dema, drejtorët: Korab Krasniqi-DUKMM, Valdrin Dogani-DBF, Arian Teneqja-DSHPE, Suhad Dullovi-DBPZHR, Urata Sopa-DAP, Lumnije Demnika Selmani-DSHMS, Arlinda Rakoci Raka-DZHET, Gazmend Bunjaku-DA, Lulzim Krasniqi-DKRS. Nga zyrtarët: Fatlume Guri-Selimi, Arianitë Bajrami, Mavije Murseli, Makfire Malsiu.

Mbledhja monitorohet nga distanca nga zyrtari i MAPL, Nehat Uka. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës, Makfire Malsiu-ZLPKK

Kryesuesi i Kuvendit - Selajdin Troni: Së pari i përshëndeti të gjithë të pranishmit, iu dëshiroi mirëseardhje, konstatoj kuorumin, kushtet pune me u mbajtur mbledhja ka, e hapi mbledhjen e III-të të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2026 të Legjislaturës së 8, data 30 mars 2026, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK, Begracë të Veli (Njazi) Luzha;
3. Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK, Kotlinë dhe Ivajë;
4. Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK, Nikaj;
5. Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK, Kaçanik;
6. Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK, Begracë, të Isak (Haziz) Luzha;
7. Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2024;
8. Raporti i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2025;
9. Plani i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2026;

10. Propozim Vendimi për Ndryshim Plotësimin e Vendimit 01Nr. 104/02-4631/26 për shpalljen në interes publik të Parcelave kadastrale në ZK Kaçanik dhe ZK Bob, sipas kërkesës së ministrisë së linjës.

Rendi i punës u ndryshua me rekomandim të KPF, ashtu që pika 2, është ndarë në pesë pikë. Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin, nuk u paraqit kush, rendin e punës e shtroj në votim, u aprovua njëzëri. Prezentë 20. Konstatohet se Kuvendi i Komunës,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 10 pikave.

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KK u aprovua njëzëri. Konstatohet se Kuvendi i Komunës

APROVOJ

Procesverbalin nga mbledhja II (dytë) e rregullt e KK, e legjislaturës së 8, për vitin 2026, të datës 26.02.2026/ Lënda: 01Nr. 060/01-4294/26.

Pyetjet dhe Kërkesat

znj. Lejla Muhaxheri Çaka: 1. Parashtrij një kërkesë të komunitetit Bob, për rregullimin e trotuarit të rrugës nga pjesa e ambulancës deri të hyrja e shkollës, për lëvizjen e këmbësorëve, në përgjithësi për sigurinë e nxënësve.

z. Jeton Luma: 1. Kërkoj nga komuna me organizuar kudo në shesh një ekran, që qytetarët e komunës me ndjekur ndeshjen Kosovë-Turqi që zhvillohet nesër, kur dihet se në stadiumin “Fadil Vokrri” është e pamundur me përcjellë të gjithë qytetarët. Kjo është një formë e mirë, që të përkrahet kombëtarja në secilin sport.

2. Kërkesa apo pyetja e dytë ka të bëjë me ndriçimin publik në Glloboçicë, të cilin e kam ngritur edhe me herët. Pyetje për drejtorin: kur do të rregullohet shtylla e dëmtuar, e cila gati që gjysmë viti është në atë gjendje?

z. Islam Gashi: Pyetje për Drejtorin e DUKMM-së

1. Me kërkesë të rrjetit të organizatave AVONET, kërkoj përgjigje të saktë: kur do të ndërmerret drejtoria veprimet e nevojshme për pastrimin e pjesës së përbashkët të rrugëve “Veteranët e Luftës së UÇK-së” dhe “Ilmi Shehu”?

2. Pyetja e dytë lidhet me infrastrukturën rrugore: a ka komuna plan për zgjerimin e rrugës “Rexhep Luzha” dhe asfaltimin e rrugës “Isen Gashi”? Segmenti nga shkolla deri në lagjen Luzha është i ngushtë, pa trotuar dhe pa ndriçim publik, me qarkullim të dendur që paraqet rrezik për këmbësorët. Gjithashtu, rruga “Isen Gashi”, që lidhet me këtë segment, ka rreth 10 shtëpi banimi dhe ende nuk është e asfaltuar.

znj. Ardita Rrahmani: 1. Paraqes një kërkesë të qytetarëve për rivendosjen e shatërvanit në vendin e tij të mëparshëm, para punimeve të Ura e Konakut. Ky shatërvan nuk ka qenë vetëm burim uji, por edhe vendtakim, pushimi dhe orientimi për qytetarët e Kaçanikut. Rivendosja e tij do të kontribuonte në rikthimin e ndjenjës së përkatësisë dhe krenarisë qytetare. Ndërtimi i asaj pjese është i mirëseardhur, por kthimi i shatërvanit në vendin e vet do të rikthente një simbol të rëndësishëm të qytetit.

2.Kërkoj rritjen e monitorimit dhe kontrollit të parkingjeve të destinuara për QKMF, pasi aty shpesh parkohen automjete nga individë të papërgjegjshëm për qëllime të tjera.

z. Kjani Zeneli: I kam disa Kërkesa të rëndësishme për qytetarët:

1.Të shtrohet rruga që lidh lagjen Zeneli me varrezat e fshatit Bob (290 m gjatësi, rreth 1950 m²), e cila lidhet me rrugën e Rambujesë dhe shërben si rrugë alternative kur punohet në lagjen Dema.

2.Të rregullohet trotuari nga ambulanca deri te hyrja e shkollës “Idriz Seferi” (rreth 80 m gjatësi, 1.5 m gjerësi), i domosdoshëm për sigurinë e nxënësve.

3.Të bëhet rehabilitimi i përroskës në lagjen Senatoriumi (rreth 250 m), që lidhet me rrugën “Esat Axhami”. Gjatë reshjeve, kjo zonë përballet me përmbytje dhe dëmtime të rrugës.

4.Të shqyrtohet elektrifikimi dhe furnizimi me ujë në zonën e Rambujesë, në bashkëpunim me KEDS dhe shoqatat e dala nga lufta, pasi mungesa e infrastrukturës po pengon investimet e qytetarëve në atë zonë.

5.Të shqyrtohet çështja e pronës “Lama e Spahisë” në rrugën “Vëllezërit Çaka”, e cila dyshohet se ka kaluar në pronësi private në mënyrë të parregullt. Kërkojmë verifikim nga kadastri dhe kthimin e saj për ndërtimin e një lapidari për dëshmorët e fshatit Bob.

6.Të zgjidhet çështja e emërimit të rrugës “Faruk Dogani”, e cila në sistem figuron me emrin “Reshat Shehu”. Familja kërkon takim urgjent me komunën para 9 prillit për zgjidhjen e këtij problemi.

znj. Ernesta Krasniqi: Kërkesa për Kryetarin dhe Drejtoritë përkatëse

1. Në fshatin Kaçanik i Vjetër, parku përballë shkollës është i rrethuar plotësisht dhe ka vetëm një hyrje në fund. Kërkojmë të shqyrtohet mundësia për hapjen e një hyrjeje të re, më të përshtatshme për banorët, qoftë në fillim të parkut apo pranë zebrave përballë shkollës, me qëllim rritjen e qasjes dhe funksionalitetit, veçanërisht për prindërit dhe fëmijët.

2.E ngriti shqetësimin për mungesën e kujdesit ndaj hapësirave të gjelbra. Kaçaniku, si zonë mes dy lumenjve, ka potencial të madh për gjelbërim. Duke qenë se është sezoni i pranverës, kërkojmë shtimin e mbjelljes së luleve dhe gjelbërimit në qytet, për të krijuar një ambient më të këndshëm dhe të gjallë për qytetarët.

Kërkojmë mbështetjen tuaj për këto kërkesa që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së qytetarëve.

znj. Lejla Luta: I kam dy kërkesa konkrete që vijnë nga nevojat e qytetarëve:

1. Zgjerimin e rrugës “Lumnije Raka” lagjja Dushkajë. Rruga është shumë e ngushtë, është afër shkollës e cila praqet rrezik për fëmijët dhe qytetarët.

2.Asfaltimi i rrugës të pllaka përkujtimore e dëshmorëve të rënë me 8 mars në Ivajë, ku rruga ka nevojë për shtrimin e saj për siguri dhe qasje të vizitorëve. Segmenti i kësaj rruge, është nga lagjja Mulak deri të monumenti përkujtimor.

znj. Kadrije Lika Troni: Unë i kam dy kërkesa:

1.Nga Drejtoria e Arsimit kërkoj listën e përfituesve të bursave për vitin 2025, në formë tabelare.

2.Nga Drejtoria e Shërbimeve Publike kërkoj sqarim me shkrim mbi përgjegjësinë për mirëmbajtjen e varrezave të qytetit, nëse kjo është përgjegjësi e komunës (DSHPE), si dhe planin konkret për muajin e realizimit të mirëmbajtjes.

z. Heset Malsiu: Në përgjigjen e DUKMM thuhet se kur të ketë mjete, do të merret projektimi i parkingut pranë varrezave të lagjes Çardaku. Unë nuk kam bërë kërkesë për këtë. Kërkesa ime ka qenë që ajo parcelë t'i jepet në shfrytëzim banorëve të lagjes në raste varrimesh. Nuk e di si lidhet kjo me çështjet financiare, dhe nuk jam e sigurt nëse duhet votuar në KK për lejimin e parcele, apo mund ta vendosë ekzekutivi. Të përgjigjet e drejtorive, mendoj se komuna ka një standard për hartimin e dokumenteve. Sugjeroj të përdoret një standard, dhe jo secila drejtori të ketë standardin e vet.

z. Buletin Guri: Unë po ndërlidhem me përgjigjen që kam marrë nga DBPZHR lidhur me kërkesën time në mbledhjen e kaluar për subvencionimin e qumështit. Nga kjo përgjigje, drejtori i bujqësisë vazhdimisht përpiqet të arsyetojë mungesën e veprimit, duke theksuar se subvencionimi i qumështit bëhet nga MBPZHR. Në të njëjtën kohë, ai e konsideron të panevojshëm subvencionimin dhe ngatërron kompetencat ndërmjet DBPZHR dhe MBPZHR.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk mundeni tani me i komentuar përgjigjet, mundeni me bërë pyetje. Mundeni me shkuar të drejtoria për komentime.

z. Buletin Guri: Kam një kërkesë nga banorët e fshatit Provoli, një komunitet i lënë pas dore. Para një muaji, gjatë reshjeve atmosferike, rruga Lunas–Arrëza është bërë pothuajse e pakalueshme. Si kryetar, besoj se jeni të njoftuar për gjendjen e saj. Po ashtu, mënyra e vendosjes së ndriçimit publik në këtë fshat është e papërshtatshme dhe e rrezikshme, është vendosur në shtylla elektrike (ping), ndërkohë që sipas standardeve duhet të vendoset në shtylla të dedikuara dhe të tokëzuara. Për më tepër, ndriçimi ndodhet rreth 7 metra larg rrugës, gjë që e bën edhe më joefektiv.

z. Jeton Luma: Si informatë: herën e fundit kur isha për homazhe, nuk e di nëse keni qenë të pjesa poshtë ku janë varrezat e veteranëve, një pllakë mungon aty. Nuk e di nëse është intervenuar, duhet të intervenohet, se janë festat, përvjetorët dhe kjo nuk jep imazh të mirë dhe ndikon keq edhe të familjarët.

znj. Ardita Rrahmani: Ndoshta është mirë se pari me trajtuar Rregulloren e punës së KK. Kur e marrim fjalën duhet me shterë debatin deri në fund, se përndryshe mundet mos me na u dhënë fjala çdo herë që kërkojmë, se po zgjatë debati pa nevojë. Kërkoj të lexoni secili rregulloren e punës së KK që na është dërguar, në të kundërtën nuk po ka efekt rregullorja që na është dërguar.

Kryesuesi i Kuvendit: Për këtë temë nuk do të hapi debat. Në rregullore të punës së KK nuk është paraparë me u ngritur kërkesa në KK, mundeni vetëm pyetje, por ne iu kemi krijuar hapësirë që me pasur qasje qytetari për pyetjet dhe kërkesat që po ngritën.

znj. Ardita Rrahmani: Është shumë e mirë kjo qasje.

Kryesuesi i Kuvendit: Fjalën e ka Kryetari i Komunës-Sabedin Vishi, se po donë me dhënë përgjigje për disa nga pyetjet:

Kryetari i Komunës-Sabedin Vishi: Ne kemi obligim t'u përgjigjemi me shkrim pyetjeve dhe kërkesave, por ka raste kur përgjigjet e vonuara nuk kanë efekt. Sa i përket ndeshjes Kosovë-Turqi, janë marrë masat e nevojshme: transmetimi do të bëhet me projektor në palestrën sportive ose në shesh, varësisht nga moti. Qytetarët do të njoftohen me kohë. Unë jam që të organizohet në palestrën sportive, për shkak të kushteve dhe hapësirës së mjaftueshme. Urojmë që kombëtarja e Kosovës të fitojë, të kualifikohet dhe të shkruajë histori duke hyrë në Kampionatin Botëror. Sa i përket pyetjes së Kjanit, jam i gatshëm të takohem me familjen e interesuar për t'i dhënë qasjen e duhur kësaj çështjeje. Për pyetjet dhe kërkesat tjera, kryesuesi nuk ua ndalon fjalën, por ato duhet të jenë të shkurtra. Nëse ka dilema për cilësinë e përgjigjeve, mund të caktohet pikë e veçantë në rend dite për debat. Më herët ka pasur ankesa për mungesë përgjigjesh, ndërsa tani drejtorët janë zotuar t'i kthejnë të gjitha. Megjithatë, për debat të gjerë në këtë moment nuk jam, përveç nëse trajtohet si pikë e veçantë, pasi dihet që jo çdo gjë është në rregull dhe në disa raste ka mangësi, ndërsa punët e mira duhen vlerësuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Pyetje e kërkesa tjera nuk ka, kalojmë në pikën e dytë:

2. Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK, Begracë të Veli (Njazi) Luzha;

Në KPF jemi pajtuar që pika 2 me ndarë në pika të veçanta, i kemi bërë. Fjalën e ka drejtorii DUKMM -Korab Krasniqi:

z. Korab Krasniqi: Ju njoftoj se dy pikë janë tërhequr që kanë qenë në KPF, për shkak të disa ankesave, kemi kërkuar informata shtesë, prej kërkuësve, kështu deri me plotësimin e tyre me informata shtesë, këto dy pikë janë hequr. Në KPF u dakordua që pikat me i pasur të veçanta, në mënyrë që askush të mos penalizohet nëse ndonjë nga pronat ka probleme. I kemi 5 Propozim Vendime për shpallje me interes, 2 janë në Begracë, 1 në Nikaj, 1 në Kaçanik dhe 1 në Kotlinë dhe Ivajë, ndërkaq është tërhequr pika në Elezaj dhe 1 në Kaçanik. Të gjitha pikat pothuajse lidhen me krijimin e rrugëve të reja. Për Kotlinë dhe Ivajë e kemi cekur se është me interes me u shpronësua të pjesa e liqenit, që komuna me pasur mundësi me investuar, se është pjesë atraktive turistike. Për të gjithë ata që kanë prona aty, do të kujdesemi me i kaluar në pronë komunale.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Kjani Zeneli: Të ZK në Begracë, ne nuk e kemi shumë të qartë, se po u ndërronte komplet prona. Është mirë me na sqaruar, për me ditur sesi me votuar.

z. Korab Krasniqi: Nuk është komplet prona, janë 2 ari e 97 metra, sipërfaqja është 24 ari, që me ia mundësuar pronarit qasjen në rrugë.

znj. Kadrije Lika Troni: Shpjegimi që po jepet vetëm me skica nuk është i mjaftueshëm. Ju jeni zotuar se sot do ta prezantoni çështjen me projektor. Unë i kam analizuar të dhënat në gjeoportali, por disa nuk kanë pasur mundësi të hyjnë për analiza më të detajuara.

Kur shikohet parcela në PK në ZK Begracë, ajo gjendet mes livadhit dhe pyjeve. Nuk ekziston plan komunal për shpallje të interesit publik. Për më tepër, prona shtrihet përgjatë një rruge publike të pakategorizuar dhe është e rrethuar me prona private. Nuk shihet ndonjë interes publik i komunës për këtë këmbim. Përkundrazi, vërehet zgjerim i pronës private. A është bërë ndonjë analizë për të vërtetuar interesin e komunës? Në këtë rast, duket se kemi të bëjmë vetëm me interes privat. Nëse komuna ka plan për zgjerimin e rrugës, kjo nuk reflektohet në terren. Aktualisht, prona vetëm po i bashkëngjitet pronës private. Mendoj se kur ekziston interes publik, komuna duhet të ketë planifikim të qartë, buxhet dhe projekt konkret, e jo që interesi individual të paraqitet si interes publik. Në këtë rast, nuk ka interes publik, por vetëm interes privat.

z. Bashkim Krasniqi: Në KPF kemi rekomanduar me u ndarë pika 2 dhe është ndarë. Unë po diskutoj për gjitha pikat, jo vetëm për këtë në ZK në Begracë. Kërkesat janë të qytetarëve që kanë nevojë me rregulluar një nevojë, rrugë apo diçka tjetër. Ne e dimë qysh janë dhënë përpara tokat nga të parët tanë, ato toka janë quajtur “mera”. Në ato parcela ka mundësi me qenë një pjesë e shtëpisë apo e rrugës. Tani qytetarët i janë adresuar me kërkesë KK me i rregulluar, dhe ne jemi këtu me shqyrtuar interesin e qytetarëve të komunës tonë. Nëse është kërkesa me i bërë disa korrigjime, ne jemi këtu me i korrigjuar. Nëse interesi privat nuk e cenon interesin publik, pse mos t’iu bëjmë zgjidhje qytetarëve. Për derisa nuk ka ankesa prej komunitetit të pronarëve aty afër, ne kemi me i mbështetur krejt këto pika sipas kërkesave të qytetarëve. Nëse me kalimin e kohës ka ankesa, e tha edhe drejtori në KPF se këto procese mundemi me i ndalur. Ne si grup i PDK jemi për, që me iu bërë zgjidhje krejt qytetarëve, qoftë për rrugë, apo për me bërë ndonjë korrigjim për me pasur qasje pronari në pronën e tij.

z. Hestet Malsiu: Kërkoj nga DUKMM që neve mos me i na dërguar këto certifikatat e licencave, se nuk është në interes tonë. Kërkesa që vjen për shpronësim, të na vjen me numrin e parcelës, arsyetimin dhe ortofotot, ndërkaq dokumentet tjera që janë bashkëngjitur, janë shumë të rëndësishme për ekzekutimin, por neve nuk mendoj se na duhen. Për ne materialet duhet të jenë sa me të shkurta dhe të qarta. Unë edhe në mbledhjen e kaluar, kam kërkuar të krijohet një grup nga secili subjekt politik për me dalë në vendngjarje, për arsye se ne nuk mundemi me i vërtetuar saktë këmbimet e pronave, sa është interesi i komunës. Me vjen mirë që Bashkimi është shumë zemërgjerë për qytetarët, uroj të jetë ashtu siç e potencoj. Unë nuk e di që dikush ka lëshuar prona prej qytetarëve, përpos që kanë uzurpua, na njofton Bashkim për raste të tilla.

z. Korab Krasniqi: Nëse ka dakordim, ne mundemi me reduktuar një pjesë të materialit, por kjo është forma zyrtare qysh duhet me u përgatitur lënda për me u dërguar në ministri. Një pjesë të materialeve që janë të ndjeshme, i kemi hequr nga materialet, përndryshe ajo pjesë shkon në ministri. Nëse ka kërkesë me hequr pjesën e certifikatës së pronës, e heqim, se e kemi bashkëngjitur me qenë sa me transparentë, mos me bërë pjesë të dosjes.

znj. Kadrije Lika Troni: Drejtor, kur e potencove se është hequr një pjesë e ndjeshme e materialit, unë nuk po e kuptoj cili material i ndjeshëm është hequr nga dosjet.

z. Korab Krasniqi: Janë hequr letërnjoftimet.

znj. Hafize Sallahi: Po ndërlihem me pjesën që e potencoj Bashkimi prona “mera”, unë e kuptoj mirë çka është ajo pronë. Mera i kanë thënë një pjese që qytetarët e kanë bërë të vetën pa qenë dhe e kanë shfrytëzuar. Në rast që qytetarët e kanë një arsye të fortë me kaluar

çështja, unë do të votoj, se në të kaluarën ka pasur raste kur qytetarët i kanë lëshuar pronat e tyre me i zgjeruar rrugët, pa kompensim. Njëra prej tyre është edhe familja ime.

Kryesuesi i Kuvendit: Sa i përket pronave, e falënderoj familjen Bela në lagjen e Re, ka shprehë dëshirën me dhënë një pjesë të parcelës për mbajtjen e manifestimeve të ndryshme. Ka që japin parcela dhe ka që kërkojnë me rregulluar një pjesë të tyre. I falënderojmë të gjithë ata që kanë ofruar prona në të mirë të përgjithshme të komunës.

z. Heset Malsiu: Për vendet ku njerëzit e kanë dhënë jetën për krejt Kosovën, me i lëshuar 30m², i falënderoj shumë, por ia kemi obligim këtij vendi. Ne po flasim për pronat ku njerëzit kanë interesa personale, me uzurpua prona, kjo është diçka tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit: Si do që të jetë prona është e shenjtë, nuk është lehtë me e dhënë. Ne po mundohemi me i ndihmuar qytetarët, ndërkaq aty ku ka probleme brenda lagjes, i kemi tërhequr pikat.

z. Korab Krasniqi: Ne i kemi 5—60 kërkesa, prej tyre janë 5 që i kemi pa me të arsyeshme. Në fillim ishin 7, për shkak të reagimeve, 2 janë në rishqyrtim. Ne mundet çdo kërkesë me iu adresuar juve, por ua kemi adresuar ato që i kemi pa me të arsyeshme. Sa i përket pronës së quajtur “meraja”, është kryesisht prona pa pronar, të cilat prona iu kanë kthyer shtetit, se janë prona pa trashëgimtarë të gjallë.

z. Kijani Zeneli: Ne po iu gjuhemi shumë drejtorit, se kjo drejtori ka me shumë probleme, se janë do drejtori me të veçanta, DUKMM dhe DA, që kanë me tepër punë dhe me shumë probleme, por edhe komuna po ngutet në disa çështje, si të prona e familjes begunca, është tërhequr ajo pikë, ka pasur kërkesë edhe Fadil Zeneli me bërë shpronësim të pronës, ajo është dashur me qenë me prioritet. Këto çështje duhet analizohen dhe shqyrtohen mirë për me qenë me prioritet, që mos të kenë procese gjyqësore.

z. Korab Krasniqi: Për familjen Zeneli që ka bërë kërkesë për hapjen e një rruge, nuk e ka plotësuar dosjen, kërkesë zyrtare nuk ka bërë, i kam treguar që në momentin që bënë kërkesën, kemi me përkrahur dhe me i ndihmuar me përgatitur dosjen.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim Propozim Vendimin dhe i njëjti u aprovua me 12 Për, Kundër 6-LVV, 3 Abstenime-VZHK. Prezentë 21. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë

VENDIM

Për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK, Begracë të Veli (Njazi) Luzha/ Lënda: 01Nr. 104/02-7242/26.

3. Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK, Kotlinë dhe Ivajë;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Korab Krasniqi: Bëhet fjalë të pjesa e liqenit në ZK Kotlinë dhe Ivajë.

z. Heset Malsiu: Është iniciativë e mirë për këmbimin e pronave të liqeni i Ivajës, se është një vend atraktiv, komuna ka interes dhe ne subjekti i jonë politik (VZHK) e përkrahim.

znj. Ardita Rrahmani: Në parim ne jemi për këtë shpronësim, duke ditur se bëhet shpronësimi i një pjese të liqenit, e që është esencial për furnizim me ujë. I ftoj të gjithë anëtarët me përkrahur.

znj. Kadrije Lika Troni: A është e potencuar drejtor se është destinimi për liqen, se nuk e pasna hasur në arsytim.

z. Korab Krasniqi: Po e lexoj arsyetimin, se nuk e di a e kemi marrë që janë ndërruar pikat. Propozimi për iniciimin e për shpallje të parcelave me interes publik të pronës së paluajtshme në ZK, Kotlinë dhe Ivajë me pronësi private të personit fizik u propozua me qëllim që të krijohet mundësi për zgjerimin të hapësirave publike e në veçanti pjesës në të cilën ndodhet liqeni dhe këmbim të parashtruar sipas kërkesës. Është saktësisht e potencuar pjesa e liqenit.

znj. Hafize Sallahi: Kërkoj falje se nuk e kam shumë të qartë, edhe pse vijë nga ajo anë. Personi që ka kërkuar me i këmbyer pronat, sigurisht e ka blerë pronën, pasi që i njëjti nuk është nga aty. Ato prona janë private, ndërkaq me kënd e bënë këmbimin nuk e kuptoj.

znj. Ernesta Krasniqi: Materiali me ndarje na ka ardhur në mbledhje, tani edhe arsyetimet po ndryshojnë. Nuk besoj se nuk iu kanë mjaftuar 2 ditë me i ndarë, se këto kanë qenë të gatshme. Tani po krijohet konfuzion këtu, se arsyetimet nuk po janë të përputhura, ne tani u njoftuam se cilat pikë janë tërhequr. Nuk është kjo korrekte ndaj anëtarëve të KK, drejtori në KPF u zotua se kam me bërë një prezantim në KK me projektor për qytetarët. Ne nuk jemi duke e ditur se çka po votojmë. Po me vjen keq, por krejt pika është konfuze. Për hera tjera besoj se kemi me i pasur të ndara pikat me herët, për me pasur të qartë se çka po diskutojmë.

z. Korab Krasniqi: Materiali është i njëjtë, vetëm propozim vendimi ka ndryshuar, se dosja është e njëjtë, janë të njëjtat prona qysh ka qenë në propozim vendimin e përbashkët, veç u ndërruan propozim vendimet me kërkesën e juaj në KPF. Arsyetimi ka qenë i përbashkët, tani është bërë i veçantë, me i zgjeruar. E vetmja vërejtje mundeni me pasur që nuk i kemi vendosur në ekran.

znj. Ernesta Krasniqi: Ne zgjerimin e arsyetimit po e kuptojmë, që të dimë se çka jemi duke votuar, se arsyetimi ka vlerë.

z. Hestet Malsiu: Kjo është ajo që kërkoja në fillim. Nuk ka nevojë të ngarkohemi me formularë, se janë të kotë për ne, por të jetë arsyetimi me qëllimin, numrin e parcelës dhe ortofotot, që të kuptojmë saktë çështjen që po votojmë. Hera tjera të përdorët ky format që na ka ardhur tani me shkrim, se ajo që na ka ardhur në email, është e paqartë qëllimi se për çka bëhet ndryshimi. Ne nuk jemi çdoherë me votuar kundër propozimet e pozitës. Ne jemi me votuar diçka që është e arsyeshme, e mos me i votuar ato që janë të paarsyeshme.

z. Bashkim Krasniqi: Lidhur me kërkesën e Hestet Malsiut për me formuar një grup me i vizituar pronat që këmbehen, është shumë e arsyeshme, për atë edhe paguhemi dhe ia vlen me formuar një grup apo në formë individuale me vizituar parcelat, për me kuptuar qëllimin e këmbimit. Sot po shihet se nuk janë kushte me pa me projektor, se i kishim kuptuar me mirë, ndërkaq me tepër përpos provave, ekzekutivi nuk mundet me na dhënë këtu. Unë kisha propozuar për ato prona që i kemi të paqarta, me shkuar në terren me i vizituar.

znj. Ardita Rrahmani: Sa e kuptova z. Malsiu, me i vizituar pronat, janë diku 50 prona që ne nuk i kuptojmë. Besoj se nuk është ligjore, se është e drejtë e DUKMM. E dyta. Arsyetimi është shumë i qartë, po e citoj: “Propozimi për iniciimin e për shpallje të parcelave

me interes publik të pronës së paluajtshme në ZK, Kotlinë dhe Ivajë me pronësi private të personit fizik u propozua me qëllim që të krijohet mundësi për zgjerimin të hapësirave publike”. Shumë e thjeshtë kjo, personi fizik i jep komunës pronë dhe me marrë nga komuna dhe komuna atë pronë e shfrytëzon për ndërtimin e liqenit. Unë jam për këtë, duke pasur parasysh mungesën e ujit, aty akumulohet uji, mendoj se përmes kësaj në të ardhmen mundet me u zhvilluar edhe turizmi aty. Ose unë nuk po e kuptoj ose ju nuk jeni duke u kuptuar.

z. Heset Malsiu: Unë e potencova se jam për me u zgjeruar hapësirat publike të liqeni, nuk me paskeni kuptuar sa duhet.

znj. Ernesta Krasniqi: Arsyetimin nuk ka nevojë me na lexuar, kërkoj mirëkuptim, por materiali iu ka ardhur vetëm shefave të grupeve të KK dhe ky arsyetim ka ardhur tani. Nëse arsyetimi kishte me ardhur me herë apo për secilin anëtar, ky material kishte me qenë me e kuptueshme. Me tregoni atë që na ka ardhur në email, ku është arsyetimi për liqenin, se nuk është askund.

Kryesuesi i Kuvendit: Në mbledhjen e KPF jemi kuptuar me u ndarë pikat. Kur kanë qenë me një pikë, e kanë pasur një arsyetim. Tani si pika të ndara, secila pikë e ka arsyetimin e veçantë. Ne nuk kemi arritur me ua dërguar materialin të gjithëve, besoj për hera tjera drejtoria do të jetë vigjilente.

znj. Ernesta Krasniqi: Arsyetimi është shumë i rëndësishëm për secilën pikë veç e veç, që të kuptoj secili anëtar i KK se për çka po votojmë. Nëse bëhet arsyetimi për krejt pronat, e kishim pasur të qartë se çka jemi duke votuar. Tani arsyetimi është i vonshëm, duhet me na kuptuar neve që nuk e kemi arsyetimin.

znj. Kadrije Lika Troni: Arsyetimin për liqenin nuk e kam kuptuar sa duhet, pasi fokusi ka qenë më shumë te parcelat – çfarë jep pronari dhe çfarë përfiton. Ne duhet të nisemi nga interesi publik: a ka projekt konkret, çfarë planifikon komuna dhe a është i buxhetuar ky projekt? Cili është interesi i komunës për t’i shpallur këto prona me interes publik? Në këtë rast shtrohet pyetja nëse kemi të bëjmë me interes të komunës apo të individit, pasi shpesh kërkesat individuale po trajtohen si interes publik. Për drejtorin: a ka komuna projekt për këtë liqe dhe çfarë planifikon të bëjë, apo bëhet fjalë vetëm për këmbim pronash? Gjithashtu, nuk është e qartë nëse pronat e përmendura në pikat 9, 10, 11 dhe 12 përfshijnë edhe Kotlinën, pasi diskutimi është fokusuar në Ivajë. Parcelat e Afrim Shabanit (Kaçanik i Vjetër) që propozohet të shpallen me interes publik janë në Kotlinë (PK 00051-0, 00058-3) dhe në Ivajë (00311-5, 00311-7, 00311-8). Nuk shihet qartë interesi publik i komunës, përveç mundësisë së bashkimit të parcelave me pronarin, prandaj kjo çështje kërkon sqarim shtesë.

z. Korab Krasniqi: Liqeni shtrihet në një zonë ku kufizohet me 3 fshatra, Ivaja, Kotlinë, Strazhë. Pjesa ku shpallet me interes është në mes Ivajës dhe Kotlinës, ai e merr një pronë të komunës në Kotlinë, i jep pronat e veta përreth liqenit. Interes i komunës është se nuk kemi qasje të liqeni. Liqeni ka me qenë prioritet edhe i kryetarit dhe DUKMM që ajo pronë me u zhvillua në aspektin rekreativ në turizëm. Kërkesa ka për investime, ne e kemi prioritet, se a ka interes publik është në domenin e juaj me vlerësuar, për derisa unë e kam prurë këtu, mendoj se ka interes publik. Pjesa e liqenit është shumë e rëndësishme dhe ajo pronë do të kalojë në pronësi të komunës.

z. Kjani Zeneli: Në parim e mbështeti që pjesa e liqenit me u bërë publike, se çka do që ndërtohet, se është në interes të komunës. Këtu shihet se nuk është shumë e qartë, se janë disa “tugjarë” të pronave që bëjnë shitblerje të pronave, në ZK Ivajë e Kotlinë, me njerëz të Ferizajt. Komuna duhet me pasur kujdes se çka po fiton, që mos të favorizon biznesmenin –

“tugjarin” e tokave, për me dëmtuar komunën. Për këtë pjesë duhet me folur me tepër Hafizja se është e asaj ane dhe Samedini, por Samedini si duket i ka kryer krejt punët këtu.

znj. Hafize Sallahi: Meqë i përkas asaj zone, e njoh mirë atë vend, fillimisht kërkova falje se nuk isha në ngjarje, por tani e kuptova drejtorin dhe iu besoj ekspertëve të komunës që punojnë në këto projekte. Fakti që ka blerës aty të komunave tjera, ne nuk i kemi dalë zot pronës tonë me hapur biznese dhe i kemi shitur pronat për interes. Për ata që hapin biznese, i përshëndesim, sepse mund të bëhen punësime aty nga komuniteti. Tani i kam të qarta çështjet, se fillimisht mendova se po jep komuna pronë të liqeni, e po merr diku në kodër, që nuk i duhet asgjë. Meqë komuna po merr pronë të liqeni, unë pajtohem dhe e mbështeti. E mbështeti edhe çdo person që donë me zhvilluar jetë në ato pjesë rurale.

znj. Ardita Rrahmani: Ne në KPF kemi kërkuar me u bërë ndarja e pikave, me na ardhur arsyetimet e ndara. Në KPF e kemi ditur që materiali na vjen të hënën, për hera tjera, arsyetimi duhet me na ardhur me kohë, përndryshe materiali na ka ardhur sot, kemi mundur me lexuar, apo me kërkuar pauzë, me u kuptua qysh po votojmë, se nganjëherë na vijnë çështje kështu ad hoc. Nëse keni mendim ndryshe, ne këtu jemi me diskutua.

Kryesuesi i Kuvendit: A ka diskutime tjera?

znj. Ernesta Krasniqi: Në momentin kur kërkoj sqarim prej drejtorit, mos na injoroni, jo vetëm mua, por asnjërin. Pyetje për drejtorin, liqeni tha kufizohet në 3 zona, ndërkaq shpronësimi është në ZK Kotlinë dhe ZK Ivajë. Në këtë rast, nuk po shpronësohet prona komplet të liqeni. Sa pronë shpronësohet të liqeni dhe kalon në pronësi komunës?

Kryesuesi i Kuvendit: E ka shpjeguar në fillim, por nuk e keni dëgjuar.

z. Korab Krasniqi: E potencova, liqeni është në prej 3 ZK, Ivajë, Kotlinë, Strazhë. Në të ardhmen mundet me kërkuar dikush shpronësimin e pronës në ZK Strazhë. Qëllimi i komunës është me i dhënë zhvillim asaj pjese. Unë jam i kënaqur që ka të interesuar prej komunave tjera me blerë pronë aty, se ashtu mundem me nxitur zhvillimin ekonomik dhe turizmin, se vetëm nga komuna jonë nuk mundet me i dhënë asi impakti zhvillimit të turizmit.

znj. Kadrije Lika Troni: Ashtu si e përmendi Ernesta, nëse është interesi publik, komuna fillimisht del me një plan konkret. Nëse ka në plan me i shfrytëzuar pronat rreth liqenit për turizëm, njëherë i shpronëson ato në këmbim, por këtu po shihet interes i një personi që ka bërë kërkesë. Mendoj se komuna-DUKMM është dashur me bërë analizë, me bërë një plan konkret që ato parcela që janë afër, me i ofruar për shpronësim, dhe me vazhduar me projektin. Kërkesa është e një individi, nuk është interesi publik i komunës që i ka shpallë me interes, se me qenë interes i komunës duhet me u shpallë të gjitha pronat që janë rreth liqenit, por këtu interesi është i një individi.

Xhelal Dema-Nënkryetar i Komunës: Kadrije, qysh po e kuptoj unë, nuk është duke u bërë komplet aty shpronësimi rreth liqenit, por është këmbim i pronës. Interesi i komunës është, se komuna po jep pronë diku me larg dhe po merr pronën afër liqenit.

z. Betim Shala: Sipas ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, shpronësimi, këmbimi i pronave mundet me u bërë edhe me kërkesën e palës, kur pala ka interes edhe komuna ka interes, nëse pronat janë në kufijtë me

njëra tjetrën, qysh është në këtë rast, që nuk po e shoh pengesë kërkesën dhe interesin e palës. Komuna nuk mundet me i marrë palës pronë pa kompensim. Në rast qysh e përmendi Kadrija që me qenë në plane zhvillimore, sipas një sqarimi të MAPL të vitit 2021, atëherë nuk ka nevojë lënda me ardhur në KK, se me një vendim të kryetarit vazhdon procedura për shpronësim. Me vet faktin që një çështje është në plan zhvillimor dhe votohet ai plan, nuk ka nevojë edhe një herë me u votuar, se nëse nuk shpallet këtu, bien në kundërshtim me planin. Në momentin që nuk ka plan, vjen këtu në KK, dhe zhvillohet procedura deri në fund. Fakti që ka ardhur në KK, e vërteton se nuk ka plan, interes pala ka, por edhe interesi i komunës është evident.

Kryesuesi i Kuvendit: Sqarimet të janë dhënë Kadrije, megjithatë urdhëroni:

znj. Kadrije Lika Troni: Betim ne nuk jemi mos me zhvilluar komunën, përkundrazi jemi me zhvilluar. Unë mendova se çfarë plani ka komuna, nëse e sheh interes komuna atë zonë, duhet me pasur një plan të gatshëm dhe buxhetin, për me filluar me zhvilluar turizmin. Kjo çështje ka ardhur në bazë të kërkesës së palës, e jo në bazë të asaj që komuna ka hulumtuar se çka donë me bërë në atë pjesë.

znj. Ardita Rrahmani: Kur kemi qenë pjesë e hartimit të PZHK në një punëtori të organizuar në vitin 2023, në Vërmicë, unë kam qenë prezentë në atë takim, ndërkaq grupi i juaj nuk e ka pa të arsyeshme me marrë pjesë. Në PZHK propozohet ti jepet hov zhvillimit të turizmit në atë zonë. Besoj se ekziston edhe procesverbal, e themi me bindje të plotë se ajo pjesë është në prioritetet e zhvillimit ekonomik, ju jeni duke e paragjykuar me të drejtë, se nuk e keni pa draftin, ndërkaq unë jam një hap para se kam qenë pjesë e punëtorisë.

znj. Kadrije Lika Troni: Me vjen mirë që po i mban mend, se në mbledhjen e fundit pati thënë se nuk mbajë mend asgjë nga ai takim, që keni zhvilluar se nuk kemi pasur draft plan përpara me analizuar me ekspertë. Kur është në pyetje zhvillimi i një vendi, për takimin që e keni zhvilluar atje, ne kemi të drejtë me kërkuar, se ne nuk vijmë atje me dhënë ide. A e din drejtor për pikën që është hequr për shpallje me interes të pronës në ZK Elezaj, a i keni bërë matjet sa pronë keni dashur me ia dhënë komunës pronë të pronarëve?

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk është në rend pune ajo çështje. Fjalën e ka Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës: Kur e kemi iniciuar me bërë një punëtori për PZHK, me ditur ku përfshihen zona turistike, kemi kërkuar me zhvilluar zonën turistike pikërisht në këtë pjesën ku është liqeni dhe kemi marrë vendim në bazë të atyre ekspertëve, ka pasur njerëz edhe nga jashtë që kanë përvojë të mirë në ministri dhe afaristë që të dal një dokument i mirë dhe aty është vendosur të shtohet në plan zhvillimi i zonës turistike në atë pjesë. Krejt ky arsytim që po behet këtu, normalisht në momentin që kemi filluar me zhvilluar atë zonë turistike, mund të bëhet një liqe artificial shumë i mirë, por për me u realizuar, duhet me shpronësuar pronën private. Tani e kemi një kërkesë për atë pjesë në këmbim me pronë të komunës, me një pjesë tjetër që është komunale. Është ide e mirë, se nëse kemi pasur me i shpronësuar 1 ha, tani i shpronësojmë 50 ari. E mira e komunës është se ruhet buxheti komunal, nëse kemi pasur me i dhënë 200 mijë euro, i japim 100 mijë, pjesa e mbetur e me buxhetit realizohet në të ardhmen me një projekt tjetër të tillë. Arsyetimi i krejt kësaj është në të mirë të zhvillimit të komunës, është i mirë, i vlefshëm, i frytshëm për qytetarët e komunës, duke ditur se komuna ka potencial për zhvillimin e turizmit, ju mundeni me qenë për kundër. Uroj të kenë të interesuar me zhvilluar turizmin jo vetëm nga komuna jonë, por edhe nga tjerat dhe nga ndërkombëtarët. Ju e dini se një pjesë iu ka dhënë pak me larg atje, ambasadës së Francës për zhvillimin e agrokulturës. Nëse merren hapa të tillë, besoj se e bëjmë me të zhvilluar

komunën e në veçanti turizmin në atë pjesë. Krejt kjo është në të mirë të qytetarëve të komunës tonë.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Propozim Vendimi e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti 15 votë Për, Kundër 6-LVV. Prezentë 21. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK, Kotlinë dhe Ivajë/Lënda: 01Nr. 104/02-7246/26.

4. Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK, Nikaj;

Kryesuesi i Kuvendit: Fjalën e ka drejtori i drejtorisë- Korab Krasniqi:

z. Korab Krasniqi: Parcela është në ZK në Nikaj, ku rruga ia ndanë pronarit pronën në 2 pjesë. Pronarji është i gatshëm me dhënë pronën, që me u krijuar një rrugë e re në pjesën e poshtme ngjitur me parcelën 254-0 krijohet rruga e re, ndërkaq rruga ekzistuese që e ndan parcelën 264-0 me parcelën 251-0 i kthehet pronarit që të bëjë një parcelë të vetme, komuna merr me tepër sipërfaqe dhe krijohet një rrugë e re.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika Troni: Parcela 00251-0 ZK Nikaj, 122 m2 e propozuar me u shpallë interes publik, shtrihet në mes livadheve dhe nuk ka kurrfarë projekti komuna të rëndësishme aty. Në skicën e dërguar, sqarimi për këmbim është i paqartë për mua.

z. Korab Krasniqi: Interesi i komunës është, krijimi i një rrugë të re në pjesën e poshtme të PK. Rruga e re bëhet në mes PK 251-0 dhe 254-0 në pjesën e poshtme të vizatimit. Aktualisht prona qysh është, pronarit rruga ia ndan pronën e vet në dy pjesë. Interesi i komunës është me këmbyer atë pjesë me një pjesë të vetën, me krijuar rrugën e re, ndërkaq pronari e bënë bashkimin e parcelave. Pjesa e dhënë në këmbim, është 1 ari e 20. Drejtori e sqaroj edhe me skicën.

znj. Ernesta Krasniqi: Pronarit si po shihet i bashkohen pronat.

z. Korab Krasniqi: Po, pronarit i bashkohen pronat, komuna krijon rrugën e re kah pjesa e poshtme.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Propozim Vendimi e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti 15 votë Për, Kundër 6-LVV. Prezentë 21. Konstatohet se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK, Nikaj/Lënda: 01Nr. 104/02-7247/26.

5. Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK, Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin: Deri sa të bëheni gati me marrë fjalën, fjalën e ka drejtori:

z. Korab Krasniqi: Z. Muharrem Berisha ka kërkuar me bërë një këmbim me pronën e tij, 9 m2, dhe me marrë një pjesë prapa parcelës 12m2. Pjesa ka e merr komuna, është pjesa ku

lidhet me pjesën korzës- shëtitores së rrugës, ndërkaq e jep komuna pronën prapa, të pjesa që është si parking. Konsiderojmë se është kërkesa e arsyeshme.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika Troni: Aty është një përroskë ku e jep komuna pronën, a mbulohet ajo përroskë dhe a duhet të merret leje nga komuna?

z. Korab Krasniqi: Ne jemi duke dhënë leje se deri ku mundet me u afrua për ndërtim, ne jemi duke shpallë me interes pronën. Pjesa që epët nga komuna, nuk kalon mbi përroskë, pjesa përpara që e merr komuna e prekë përroskën.

z. Kjani Zeneli: Ne e njohim mirë terrenin e Kaçanikut. Kjo pjesa përreth korzës përreth sheshi apo Bulevardit Ismail Raka, është interes i komunës të zgjerohet rruga e sheshit të qytetit, ndërkaq duhet me shikuar mundësinë në të ardhmen me bërë diçka për përroskën, a me mbuluar e me bërë një rrugë kaluese, sepse ka edhe kundërmim të erës aty. Në parim e përkrahim këtë shpallje me interes të pronës.

znj. Ernesta Krasniqi: Duke iu referuar materialit që e kemi, të arsyetimi nuk e di a është gabim, se thuhet ZK Kaçanik, në arsyetim thuhet ZK Nikaj. A ka të bëjë kjo diçka me ZK Nikaj.

z. Korab Krasniqi: Ka mundësi se është gabim, e korrigjojmë gabimin teknik.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë me një korrigjim teknik, Propozim Vendimi e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti 15 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 6 anëtarë -LVV. Prezentë 21. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK, Kaçanik/ Lënda: 01Nr. 104/02-7244/26.

6. Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK, Begracë, të Isak (Haziz) Luzha;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin: Deri sa të bëheni gati me marrë fjalën, fjalën e ka drejtori:

z. Korab Krasniqi: Në këtë pjesë, nëse e shikoni hartën, rruga qysh është e shtrirë, nuk përkon me ndarjen kadastrale. Andaj do të bëhet pjesa e korrektimit të rrugës, me i bërë kufijtë qysh janë në praktikë. Kur është shtruar rruga, nuk është bërë sipas trasesë së rrugës, andaj bëhet korrektimi i saj, pronari që ka pjesën kah rruga, ia jep atë pjesë rrugës dhe e merr pjesën që nuk ka hyrë në rrugë dhe bëhet traseja në kadastër del saktësisht qysh është rruga, se një pjesë e komunës nuk është e asfaltuar, ndërkaq pjesa e pronarit është e asfaltuar, bëhet këmbimi i këtyre parcelave dhe korrektimi i rrugës.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Brahim Imishti: Ne jemi të thirrur këtu me iu krijuar lehtësira qytetarëve dhe me krijuar hapësira për zhvillimin e turizmit, zhvillimin ekonomik, që secila parcelë që epët, të jep mundësi çdo biznesi çdo kund. Janë dy pika këtu në ZK Begracë dhe në ZK, Nikaj, ndërkaq janë dy anëtarë të KK këtu nga këto lokalitete përfaqësuese, nuk e di këta si mundën me i neglizhuar interesat e atyre lokaliteteve. Iu kisha inkurajuar që interesi qytetar të jetë mbi atë partiak.

znj. Kadrije Lika Troni: Po foli në emër të LVV. Është e drejta e secilit anëtar sesi voton. Ju nuk keni të drejtë me i treguar askujt si voton. Ju mundeni me fol për vetën tuaj si votoni, e jo për Islamin apo për dike tjetër.

z. Brahim Imishti: Edhe pse e shihni një zhvillim ekonomik me këto shpronësime, nuk i përkrahni për inate politike.

Kryesuesi i Kuvendit: Brahim të lutem, është e drejta e tyre sesi votojnë.

z. Bashkim Krasniqi: Kadrije, e kam një kërkesë, këshillë apo sugjerim, që të luani rolin e opozitës këtu, se ju po bëni opozitë edhe këtu edhe në rrjete sociale.

znj. Kadrije Lika Troni: Nuk keni nevojë me dhënë këshilla mua. Kryesues kërkoj të mbani rendin, ndalja fjalën.

z. Bashkim Krasniqi: Herën e kaluar një zyrtar i komunës e ka bërë një gabim teknik, gjë që është normale me bërë gabime teknike, na jeni drejtuar neve për një gabim teknik. Kur të na drejtoheni, dine se edhe iu kundërvihemi.

znj. Kadrije Lika Troni: Kryesues, ose ndalja fjalën ose e lëshojmë mbledhjen, nuk dua me më dhënë këshilla, se nuk kam nevojë. Kryesues, nuk ka të drejtë askush t' me drejtohet se çka shkruaj në rrjetet sociale, ajo është e drejtë e imja.

z. Islam Gashi: Se qysh votoj unë, unë ju jap përgjegjësi votuesve të mi. Nëse nuk i përfaqësoj mirë, në zgjedhje me vlerësojnë. Qysh votoj unë, besoj se kam nivel të diturisë me të mirë sesa të tuajën. Ju njëherë jepni leje, pastaj mundoheni me i kompensuar me pazaret e juaja.

znj. Ernesta Krasniqi: Në KK nuk kemi secili përfaqësues nga secili fshat dhe unë nuk e përfaqësoj vetëm Kaçanikun e Vjetër, unë e përfaqësoj komplet komunën e Kaçanikut, ndërkaq ju po e ndani sipas lokaliteteve, që Islami me përfaqësuar f. Begracë, ndërkaq Buletini f. Nikaj. Unë kur e kam një shqetësim pavarësisht nga cili komunitet, e kam të drejtën me ngritur si çështje, ndërkaq se qysh votoj unë, është çështje e jona. Qysh e bëjmë opozitën, është çështja e jona. Ne kemi qenë në garë e cila na ka vlerësuar dhe jemi këtu me bërë opozitën. Tjetra, me të ardhur keq qysh kontrollohet opozita se çka bënë në rrjete sociale. Këtu mundeni me diskutuar qysh e bëjë opozitën unë dhe shqetësimet që ngriti. Kadrija e ka ngritur një shqetësim, për emrin, ndërkaq Bashkimit iu kujtua me mbrojtur ekzekutivin pas një muaji, e jo kur u ngrit çështja.

Kryesuesi i Kuvendit: U krye kjo çështje Ernesta.

znj. Ernesta Krasniqi: Kryesues, kur të dalim prej rendit të punës, me mbajtur rendin e ditës, qysh po e mban për neve, në të kundërtën të bëjmë zhurmuesin.

Kryesuesi i Kuvendit: Kërkoj të mos dilni jashtë rendit të punës.

znj. Elona Gjini: Kur po thoni me mbajt rendin e punës, këta janë që në mbledhjen e kaluar nuk iu kanë përmbajtur rendit të punës, e kanë fyer edhe kryetarin e komunës.

znj. Ernesta Krasniqi: Nuk jemi para komisionit disiplinor, është çështje imja se çka foli. A keni krijuar grup disiplinor këtu?

Kryetari i Komunës: Kërkoj të merremi vetëm me pikat e rendit të punës, e mos të zhvillohet debat pa nevojë, se jemi drejtpërdrejtë para qytetarëve, se këto diskutime

reflektojnë edhe tek qytetarët e komunës. Vitin tjetër, kisha kërkuar të diskutojmë çështjen e ndërtimit të një salle të KK, kryesues, po e shoh se po keni vështërsi me ua ndal edhe fjalën, se në këtë formë, është e pamundur me ia ndalë fjalën, ndërkaq kur të krijohen kushtet në sallën e KK, bëhet me e lehtë ndalja e fjalës.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne ua kemi dërguar edhe rregulloren e punës së KK, ku keni pasur mundësi se çka mundemi me bërë. Kërkoj që mundësisht mos me kaluar në ofendime, ndërkaq nëse keni me bërë pyetje edhe jashtë teme, i tolerojmë, por jo ofendimet. Diskutime të tjera nuk ka, Propozim Vendimin e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti 15 votë Për, 6 votë Kundër-LVV, Abstenim nuk ka. Prezentë 21. Konstatohet se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK, Begracë, të Isak (Haziz) Luzha/ Lënda: 01Nr. 104/02-7244/26.

7. Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2024;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin;

z. Islam Gashi: Ky raport tregon një situatë shqetësuese: nga 12 rekomandime, 2 janë zbatuar plotësisht, 7 pjesërisht dhe 3 aspak. Kjo reflekton një qeverisje që nuk ka adresuar dobësitë në menaxhimin e financave publike. Rekomandimi B5 tregon se problemi ka ekzistuar, por është zbutur për shkak të lidhjes me sistemin informativ të menaxhimit të financave publike dhe e-prokurimit, jo për shkak të disiplinës së brendshme të zyrtarëve. Në rastin e A6 (mos funksionalizimi i NJAB), problemi lidhet me neglizhencën e menaxhmentit dhe reagimin e vonshëm të kryetarit që po dilte në pension. Raporti evidenton keq klasifikim të shpenzimeve me qindra mijëra euro, pagesa nga linja buxhetore e gabuar (sidomos për kontrata të banimit social), obligime kontraktuale pa buxhet të mjaftueshëm, vonesa të projekteve kapitale nga 207 deri në 524 ditë, mos inspektim të pronave, rritje të llogarive të arkëtueshme dhe dështim të e-prokurimit. Sipas raportit, në vitin 2024 komuna nuk ka kryer asnjë inspektim të pronave të paluajtshme, ndonëse ligji kërkon të inspektohen 20%. Kjo tregon performancë të dobët dhe moszbatim të ligjit, duke sjellë humbje të të ardhurave dhe shkelje ligjore. Pyetje kryesore: kush mban përgjegjësi, sa vite nuk ka pasur inspektim, sa janë të hyrat e humbura dhe pse nuk janë përdorur alternativat private për inspektim? Rritja e llogarive të arkëtueshme është 342 mijë euro brenda vitit, kryesisht nga tatimi në pronë, duke rritur rrezikun për humbje të të ardhurave dhe kufizim të investimeve. Auditimi evidenton edhe borgje të vjetra joaktive; pyetje: sa është vlera e borgjeve mbi 3 vite dhe sa lidhen me tatimin në pronë? Dobësitë në menaxhimin e kontratave përmes e-prokurimit rrisin rrezikun për mungesë transparence. Katër kontrata kapitale (asfaltimi i rrugëve rurale, ndërtimi i sallës së sporteve, ndërtimi i objektit të zjarrfikësve dhe ndërtimi i kanalizimeve në f. Begracë) me vlerë rreth 1 milion euro nuk janë dokumentuar si duhet në sistem.

z. Hestet Malsiu: Ne këtë raport do të ruajmë si referencë për raportin e vitit të arshëm, ndërkaq se nuk do t'iu fajsojmë për këtë raport.

Kryetari i Komunës: Faleminderit për pyetjet në raportin e auditimit. Sa i përket rekomandimeve, pjesa dërmuese e parregullsive lidhet me kontratën kolektive. Pajtohem me inspektimin e pronave, por shumica e problemeve vijnë nga obligimet brenda kategorive për

shkak të kësaj kontrate, e cila prek të gjitha komunat në nivel vendi dhe është ngritur shpesh edhe në AKK. Disa komuna e kanë më të theksuar këtë problem për shkak të investimeve nga niveli qendror. Mjetet janë alokuar dhe, në disa raste, janë marrë pa konsultim. Për shembull, para fillimit të procedurës për sallën në Dubravë, rreth 113 mijë euro janë marrë nga thesari. Të gjitha këto pagesa burojnë nga kontrata kolektive, pavarësisht kush e ka nënshkruar atë. Kontrata është nënshkruar nga Ministri i Arsimit, Ministri i Financave dhe Sindikata e Arsimit në nivel vendi. Edhe pse kryetarët e komunave nuk e kanë nënshkruar, barra po bie mbi komunat, të cilat po obligohen të paguajnë paditë e mësimdhënësve dhe profesorëve, të cilët kanë të drejtë të kërkojnë mjetet që u takojnë. Në krahasim me komunat tjera, përmes punës së Drejtorisë së Arsimit dhe zyrtarëve janë arritur një numër i madh marrëveshjesh, duke shkurtuar rreth 700–800 mijë euro. Edhe këtë vit pritet që rreth 800 mijë euro të merren nga buxheti për shkak të kontratës kolektive, duke detyruar të tërhiqen mjete nga projekte të planifikuara për shlyerjen e borxheve ndaj arsimtarëve dhe profesorëve. Sa i përket obligimeve tjera, drejtori mund të japë sqarime më të detajuara. Për regjistrimin e pronave, është e vërtetë se ka pasur mangësi, por po punohet për përmirësim. Vendimi i nivelit qendror që pronat deri në 30 mijë euro të mos taten ka ndikuar në uljen e inkasimit, pasi në komunën e Kaçanikut një pjesë e madhe e pronave bien nën këtë vlerë. Po ashtu, vonesat në tatimin në pronë lidhen me shtyrjet e vendimeve nga niveli qendror.

z. Islam Gashi: Nuk po me pëlqen arsytimi, se edhe në raport thuhet se shumica janë si rezultat i kontratës kolektive, qysh ju pengon kontrata kolektive me bërë inspektim të pronave. Mosregjistrimi i pasurive çështja A1, çka ka faj kontrata kolektive? Të rasti tjetër, pagesa e projekteve prej linjave tjera buxhetore, rasti i ndërtimi të objektit të banimit social, çdo arsytim po e lidhni me kontratën kolektive.

Kryetari i Komunës: Është e vërtetë se kemi bërë pagesa prej linjave tjera buxhetore, që realisht nuk është e mirë, mund të jenë edhe shkelje, për atë mund të marrim vërejtje prej auditorit, por me pas qenë ju në vendin tim, si kishi me vepruar? Nëse vjen puna me marrë mjete prej një projekti për pagesën e borgjeve të kontratës kolektive ose mjetet me i kthyer në suficit buxhetor, cilën metodë e kishi zgjedhur?

z. Islam Gashi: Është dashur me qënë të planifikuara mjetet për kontratën kolektive.

Kryetari i Komunës: Qeveria është dashur me një vendim me i shlyer të gjitha obligimet si rezultat i kontratës kolektive.

z. Islam Gashi: Qeveria ka vendosur për krejt komunat me pasur obligim borgjet sipas kontratës kolektive, jo vetëm për komunën e Kaçanikut.

Kryetari i Komunës: Qeveria komunës së Shtimës ia ka proceduar 55 milion euro, ndërsa komunës tonë asnjë cent. Shifrat janë zyrtare në faqe të komunës për 4 vite, ndërkaq komunës tonë, 1 milion euro për 4 vite për ndërtimin e çerdhes së fëmijëve. Ne është dashur me marrë diku mjete për shlyerjen e borgjeve sipas kontratës kolektive.

z. Jeton Luma: Nuk është mirë kryetar me adresuar fajin vetëm të neveli qendror. A keni pasur kërkesa në nivelin qendror, se ju nuk keni adresuar kërkesa për banim të përbalueshëm.

Kryesuesi i Kuvendit: Jeton ju nuk keni qenë në atë kohë anëtar i KK, mund të mos keni njohuri të mjaftueshme për ato çështje.

Kryetari i Komunës: Unë e pranova aty ku e kemi faj ne si komunë, por i adresova edhe aty ku ka faj niveli qendror.

znj. Kadrije Lika Troni: Edhe në KPF e kam theksuar, po e theksoj edhe këtu se ky raport nuk ka qenë i mirë i vitit 2024. Kryetari ka qenë pjesë e ekzekutivit-nënkryetar komune, ku nga 12 gjetje, 2 janë zbatuar terësisht, 7 pjesërisht, 3 të pazbatuara. Pyetje për kryetarin, të inspektimi i pronave, a e ka shkalur komuna ligjin në këtë rast? Të projektet kapitale, të vonesat, në kemi vonesa deri 524 ditë, a është marrë diçka ndaj operatorit? Kontrata kolektive nuk mendoj se ka qenë rezultat i këtyre vonesave.

Kryetari i Komunës: Të pjesa e inspektimit, kemi me marrë masa, kjo është në dobi të komunës. E pranoj se në vitin e kaluar nuk kemi marrë masa, ndërkaq zotohem se do të kryejmë këtë punë. Sa i përket vonesave të projekteve, sheshi është vonuar me shumicë, nënkalimi, vonesat ndodhin në krejt komunat, vonesa me e madhe është të ndërtimi i shkollës “Ali Asllani” në Doganaj.

znj. Ernesta Krasniqi: Kam pasur pyetje konkrete, ndërkaq nuk e kam marrë përgjigjen për vonesën e ndërtimit të projektit të nënkalimit të këmbësorëve.

Kryetari i Komunës: Të nënkalimi, ju kam përgjigjur direkt në mbledhje.

znj. Ernesta Krasniqi: Janë procesverbalet, unë nuk e kam marrë përgjigjen.

Kryetari i Komunës: Nëse me keni adresuar direkt mua pyetjen e nuk iu kam përgjigjur, kërktoj falje.

z. Korab Krasniqi: Unë të kam dërguar Ernesta përgjigjen në dy emaillet.

Kryetari i Komunës: Kur është filluar projekti i nënkalimit, kam qenë nënkryetar i komunës, ka pasur ankesa të qytetarëve të arsyeshme, për shkak të shkollës. Kemi pasur tentativa në ministri me bërë një projekt, nuk kemi pasur mjete financiare, është dashur me i zvogëluar disa projekte, me bërë nënkalimin se paku për këmbësor. Meqë është nënkalimi në nivel të lumit neredime, e kemi bërë përkohesisht me pompa, është trajtuar uji në mes. Ndodhë që ndonjëherë pompat nuk funksionojnë me qëllim apo pa qëllim dhe pompat mbushen me ujë. Zgjidhja përfundimtar nga matjet që janë bërë, është diku të pjesa përfundi e bunarit që ka qenë, aty uji është me rënie të lirë. Për shkak mos me bërë ndërhyrje të shpeshta në shetitore, jemi duke e pritur projektin e kolektorit e ujërave të zeza, me shfytëzuar të njëjtin kanal, që mos me prishë projektin shumë shpesh. Uroj të bëhet sa me parë projekti i kolektorit dhe kërktoj të na ndihmoni në këtë aspekt me shkuar me juve bashkë të LVV në qeveri.

z. Islam Gashi: Nuk i mora të gjitha përgjigjet në krejt pyetjet. Që sa vite nuk ka inspektim të pronave, me sa të hyra u dëmtua komuna nga mosinspektimi i pronave? Nëse nuk ka inspektim të pronave, sa mendoni se e keni dëmtuar sistemin e tatimit në pronë, nëse krahasojmë tatimin e viteve të pasluftës që kanë paguar tatim në pronë, me pronat fjala vjen të ndërtuara në vitet 2023-2024, të cilat nuk paguajnë tatim në pronë në mungesë të stafit për evdntimin e tyre. Pse komuna nuk ka përdorur alternativat tjera përmes kompanive private, me bërë inspektimin e 20 % të pronave në respektim të ligjit? Sa % e pronave e

borgjeve të arkëtueshme lidhen direkt me tatimin në pronë, sa është vlera e borgjeve deri në 3 vite?

z. Valdrin Dogani: Është një raport periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna auditori i përgjithshëm. Neve na vjen raporti, e dërgojmë në KK për diskutim, pastaj ekzekutivi e përgatit planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, pastaj janë datat 30 shtator dhe 15 mars si afate të fundit ku ne deklarohe mi se sa janë zbatuar rekomandimet. Edhe unë kam qenë pjesë e tatimit në pronë kur është kryer anketimi i fundit në vitin 2023, mundësitë buxhetore dhe kufizimet në punësim brenda stafit, nuk po na lejojnë me punësuar staf për zyrën e tatimit në pronë. Zyra e ka shefin dhe 2 zyrtarë tjerë që ofrojnë shërbime për tatim në pronë. Në planin e ekzekutivit të pjesa e DBF, e kam paraqitur me kontaktuar kompani private, me i evidentuar pronat, që kjo gjetje mos me na u përsëritur në vitin 2027, se qysh atëherë përmirësohet kjo gjetje. Nëse ne e bëjmë ri anketimin tani, raporti i auditorit vjen në vitin 2027. Si ekzekutiv kemi me marrë veprime që kjo gjetje mos me figuruar më.

Nënkryetari i Komunës: Të tatimi në pronë, është duke çaluar puna jo vetëm në komuna por edhe në kuadër të ministrisë, se ende nuk kemi ngarkesë të tatimit në pronë për vitin 2026. Kjo nuk e arsyeton mos regjistrimin e pronave, por është duke çaluar krejt sistemi, edhe me i pasur punëtorët për terren, nuk mundet me u funksionalizuar, se ato pajisjet nuk janë të lidhura me sistemin. Ende pa u ngarkua tatimi në pronë për vitin 2026, është shtyrë afati i pagesës.

z. Islam Gashi: A ka borgje të tatimit në pronë me të vjetra se 3 vite? Mosinpektimi i pronave duhet me marrë si problem të gjithë, se kjo formë po krijon pabarazi të qytetarët, se ka prona të ndërtuara para lufte, që paguan tatim në pronë, ndërkaq në anën tjetër ka prona të ndërtuara të reja për të cilat nuk paguhet tatim. Nëse është në pyetje, çështja e stafit, është mirë me bërë zgjidhje me kontraktim të ndonjë kompanie private, se ajo kosto arsyetohet me me atë inkasohet, po themi në formë indirekte se tatimi në pronë iu kthehet qytetarëve në projekte.

z. Valdrin Dogani: Nëse ka ndryshime në pronë, edhe qytetari e ka obligim ligjor me lajmëruar për pronën.

z. Islam Gashi: Qytetari e ka obligim ligjor me lajmëruar pronën, ndërkaq komuna e ka obligim me arkëtuar atë pronë.

z. Valdrin Dogani: Në bashkëpunim me DUKMM kemi me bërë një plan për objektet e që kërkojnë të legalizohen, me i regjistruar në tatimin në pronë, se dihet edhe sipërfaqja e tyre dhe me paguar tatimin në pronë. Në vazhdim drejtori foli për inkasimin e të HVK si në raport financiar që është 2 milion e 529 mijë 649 euro, prej tyre 89% janë nga të hyrat e tatimit në pronë, 3% nga ushtrimi i veprimtarive afariste, tjerat nga qiraja. Kjo shihet që në krahasim me vitin 2024, të HVK kanë shënuar progres.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, raporti nuk votohet. Konstatohet se Kuvendi i Komunës

NJOFTOHET

Me Raportin periodik për zbatimin e rekomandimeve për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2024/ Lënda: 01Nr. 400/01-6386/26.

8. Raporti i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2025;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Kjani Zeneli: Në raport ka edhe çështje të mira, ndërkaq i kam edhe vërejtjet e mia. Me komandantin e ri që ka ardhur, shihet se ka plan për siguri të qytetarëve, ndërkaq ish komandanti i mëhershëm i policisë për mua është i dështuar në të gjitha fushat e sigurisë, sot ndihem i turpëruar me diskutuar raportin e vitit 2024, ku sot 1 vit është vrarë polici Muhamed Lika.

Kryesuesi i Kuvendit: Jemi duke folur për raportin e punës të vitit 2025, e jo për planin e punës.

znj. Kadrije Lika Troni: Raporti i KKSB trajton tema, si vandalizmi, dëmtimi i pronës publike, siguria në shkolla, përdormi i substancave narkotike dhe mbrojtja e mjedisit. Unë po e ngriti një shqetësim me madhor, ku qytetarët tanë u lënduan nga djegia e varrezave të qytetit- një akt i shëmtuar, kjo ngjarje nuk është përmendur në raport, asnjë diskutim, analizë, asnjë rekomandim. Unë në mandatin e kaluar kam kërkuar që kryetari të thërret një mbledhje urgjente, të trajtoj këtë çështje, dhe kam kërkuar sqarim nga BI se kush mban përgjegjësi për mirëmbajtje të varrezave, por deri me sot gjithçka ka mbetur në mjegull. Edhe pse shumica e anëtarëve ishin prezent, nisur nga kryetari i komunës-kryetari i KKSB, komandanti i policisë, përfaqësues i zjarrfikëse, përfaqësuesi i BI, kjo çështje nuk trajtuar dhe marrë seriozisht, pavarësisht se kërkesa ka ardhur nga anëtari i KK e që KK është mbikëqyrës i KKSB. A nuk është djegia e varrezave një akt vandalist me ekstrem? Kjo të mbetet në përgjegjësi e secilit anëtar të KKSB të mandatit të kaluar, se ky raport nuk është i kompletuar përderisa nuk ka dalë asnjë diskutim dhe asnjë rekomandim për këtë akt të shëmtuar. Të siguria, në raport shënohen rekomandimet se duhet të ketë kamera të sigurisë, por me atë rast nuk është asnjë vendim apo nuk është ecur tutje me çështjen e sigurisë.

Kryetari i Komunës: Të rekomandimet, nuk është e vërtetë që të gjitha rekomandimet që dalin, nuk zbatohen. Për gjendjen e sigurisë publike, raporton komandanti i policisë, ndërkaq për krimet e rënda, nuk merret KKSB me këtë. Të siguria në shkolla,

znj. Kadrije Lika Troni: Kryetari i komunës nuk ka qenë kryesues i KKSB, ndërkaq nëse flet për KKSB që nuk ka qenë, nuk besoj se mundet me vazhduar tutje. Raporti është i KKSB i ish kryetarit të legjislaturës së kaluar.

Kryetari i Komunës: Çdo kryesues i KKSB e ka zëvendës kryesuesin. Unë kam qenë dhe kam marrë pjesë në KKSB kur ka munguar kryetari dhe jam në rrjedhë të shumë çështjeve. Nëse ju mendoni se nuk duhet me u përgjigjur, nuk përgjigjem, por kjo ka ardhur si pikë e diskutimit në KK, se dikush duhet me raportuar. Unë po iu themi se disa rekomandime janë zbatuar. Të siguria në shkolla kemi marrë hapa konkret, të çështja e kamerave, pritet me u lidhur kontrata. Me ish komandantin e policisë nuk kemi mundur me gjetur bashkëpunim, se ishte kompetencë e MPB- policisë së Kosovës, krejt jeni dëshmitarë të kësaj. Tani e kemi gjetur një formë dhe shumë shpejt kemi me u pajisur me kamerat e sigurisë. Të substancat narkotike, është bërë një inspektim të të gjitha shkolla, me rekomandim të KKSB, por këtë e kemi edhe obligim si ekzekutiv me iu përgjigjur. Të respektimi i ligjit në komunikacion, edhe këtu ka pasur çështje sa i përket kompetencës, në bashkëpunim me policinë, ka pasur përmirësim të jashtëzakonshëm. Në bazë të vlerësimeve të ministrive tjera, KKSB e komunës tonë është me funksionale, ne i paguajmë anëtarët, shumica e komunave nuk i paguajnë, tani kemi me i paguar me ngritje mëditjet sipas ligjit në fuqi dhe shpresoj që KKSB të jetë edhe me frytdhënëse.

znj. Kadrije Lika Troni: Kryetar, unë nuk desha me iu ngarkuar nuk keni qenë pjesë, por pasi po doni me marrë përgjegjësinë, me tregoni pse ju keni heshtur kur unë kërkoja që

djegia e varrezave të qytetit është një akt i shëmtuar dhe i ka prekur krejt qytetarët e qytetit. Pse nuk keni dal me një sqarim në KK për aktin vandal të shëmtuar?

Kryetari i Komunës: Kur është raportuar rasti i djegies së varrezave, menjëherë janë dalë zjarrfikësit dhe kanë intervenuar të varrezat e qytetit. Këtë çështje e kemi ngritur edhe në KKSB dhe ata-zjarrfikësit kanë thënë se për çdo rast që është lajmëruar, kemi intervenuar.

znj. Kadrije Lika Troni: Në KKSB ndoshta e keni diskutua, por në raport nuk figuron. Kjo çështje ka qenë shumë e ndjeshme, unë kam pasur kërkesa prej shumë qytetarëve, për atë unë sot e ngrita kërkesën për mirëmbajtjen e varrezave të qytetit. Merre për sipër këtë çështje me ekzekutivin që të dihet se kur ka me u pastruar varrezat e qytetit, se pronat publike mirëmbahen nga komuna.

Kryetari i Komunës: Faleminderit për urdhëresën. Për tema të mëdha çështjet shqyrtohen, ndërkaq si tema veç e veç, si p.sh. djegie të shtëpive, nuk raportohen.

Kryesuesi i Kuvendit: Diçka tjetër nuk ka në këtë raport. Raporti nuk votohet, kalon si informatë. Konstatohet se Kuvendi i Komunës,

NJOFTOHET

**Me Raportin e punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2025/
Lënda:01Nr. 104/02-6028/26.**

9. Plani i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2026;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Ernesta Krasniqi: Në këtë plan nuk janë paraparë dy çështje shumë të rëndësishme për sigurinë publike: kamerat e sigurisë në qytet dhe qentë endacak. Mungesa e trajtimit të këtyre dy temave, është shqetësuese, tema këto që lidhen drejtpërdrejtë me sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve. Kamerat e sigurisë janë mjet thelbësor për parandalimin e veprave kriminale, rritjen e sigurisë në hapësira publike dhe ndihmën ndaj organeve të rendit për identifikimin e rasteve problematike. Prandaj, është e domosdoshme kjo çështje të diskutohet dhe të hartohet një plan konkret për zgjerimin dhe funksionalizimin e tyre. Para një viti kur është diskutuar çështja e kamerave të sigurisë, pas 2-3 ditëve ndodhi rasti konkret, vrasja e policit. Aty e kuptuam sa e rëndësishme janë kamerat e sigurisë. U përmend nënkalimi se dikush mundet me hequr pompën. Kamerat e sigurisë janë të rëndësishme me ditur se kush po i bënë këto dhe drejtësia të vendoset në vend. Qentë endacak, paraqet rrezik të vazhdueshme për qytetarët në veçanti për fëmijët. Kjo çështje kërkon po ashtu trajtim serioz dhe zgjidhje të qëndrueshme, përmes një plani të qartë dhe veprime konkrete. Për këto arsye, kërkoj që këto dy tema të përfshihen me prioritet, në KKSB, dhe ta hapet diskutim i mirëfilltë për gjetjen e zgjidhjeve konkrete. Për kamerat, në mandatin e kaluar ka qenë kërkesë e vazhdueshme, ndërkaq nga kryetari Ilazi, gjithmonë është thënë se i takojnë policisë, ndërkaq në procesverbale komandanti thoshte se kjo kompetencë i takon komunës. Shpresoj që në këtë mandat Kryetari të definon se kujt i takon kjo përgjegjësi dhe të epët një dritë e gjelbër për funksionimin e tyre.

znj. Ardita Rrahmani: Ekziston një plan për trajtimin e qeneve endacak në Strategjinë kombëtare, të cilin e kanë nënshkruar të gjitha komunat, i cili përmban një plan të veprimit për kontrollin e qeneve me dhe pa pronarë. Nëse kishte me u zbatuar ky plan, nuk kishim pasur nevojë në çdo të dytin muaj në KKSB me diskutuar këtë temë. Çështjet e kamerave të sigurisë, e kemi diskutuar disa herë, me vjen mirë që është arritur një marrëveshje që është

në procedurë, uroj që me një presion me u zhvilluar këto procedura sa me shpejtë, që me iu dhënë zgjidhje punës së kamerave të sigurisë.

z. Heset Malsiu: Në planin e këtij viti nuk shihet që të trajtohet siguria e ambientit. Kërkoj që t'i kushtohet rëndësi mbrojtjes së mjedisit, veçanërisht lumenjve që po ndoten dhe degradohen çdo ditë, si dhe sigurisë së pyjeve. Pyjet janë dëmtuar edhe më herët dhe, megjithëse janë mbajtur takime, nuk janë parë efekte konkrete te qytetarët për mbrojtjen e tyre. Gjithashtu, në plan thuhet se deri më sot nuk ka pasur plan konkret për sigurinë në shkolla, ndërsa si rezultat i pritshëm përmendet hartimi i një plani të tillë. A ka pasur apo jo plan konkret për rritjen e sigurisë në shkolla?

Kryetari i Komunës: Çështja e kamerave të sigurisë është e qartë sa i përket kompetencave -ato i takojnë institucioneve që i monitorojnë. Aktualisht jemi në përfundim të një zgjidhjeje dhe, pavarësisht vështirësive apo ndonjë shkeljeje të vogël, po bëjmë maksimumin për ta finalizuar. Procedura është në zhvillim; nëse nuk ka ankesa, kontrata do të lidhet, ndërsa në rast ankesash procesi zgjatet. Sa i përket qenve endacakë, mungesa e një strategjie të mirëfilltë kombëtare e bën të vështirë gjetjen e një zgjidhjeje afatgjate. Masat si kastrimi ndihmojnë, por nuk e eliminojnë plotësisht problemin. Trajtimi dhe zhvendosja e tyre nuk janë zgjidhje të qëndrueshme, pasi qentë mund të rikthehen ose të vijnë nga komuna të tjera. Jemi të hapur për çdo propozim që mund të ndihmojë në zgjidhjen e kësaj çështjeje. Për sigurinë e ambientit, është caktuar lokacioni për mbeturina inerte dhe pritet që brenda javës të nënshkruhet një marrëveshje për zgjidhje afatgjate. Gjithashtu, do të shpallet një muaj sensibilizimi për pastrimin e ambientit, në kuadër të Ditës së Tokës më 22 prill, ku do të përfshihen të gjithë akterët relevantë. Edhe pse ekziston kontratë për pastrimin e deponive ilegale, mungesa e një lokacioni të përshtatshëm ka vështirësuar punën e inspektorëve. Janë ndërmarrë hapa për vendosjen e kamerave në zonat problematike, si të "Guri i Zi", dhe do të shtohet numri i tyre. Po ashtu, do të krijohet një komision i përbashkët me kompaninë "Pastërtia" për të identifikuar zonat ku qytetarët nuk paguajnë shërbimet e mbeturinave, me qëllim vendosjen e masave ndëshkuese. Deri më tani, mungesa e një lokacioni për mbeturina inerte ka qenë pengesë për shqiptimin e gjobave ndaj ndotësve. Sa i përket sigurisë në shkolla, kjo çështje është trajtuar vazhdimisht në KKSB. Janë ndërmarrë masa për kontroll më të rreptë dhe është kërkuar sigurim fizik. Në gjimnaz kjo tashmë është realizuar, ndërsa shumë shpejt pritet të zbatohet edhe në shkollën e mesme profesionale, me qëllim uljen e rasteve të vandalizmit.

z. Jeton Luma: Unë e ndajë të njëjtin shqetësim me kolegun sa i përket pyjeve.

Kryetari i Komunës: Të pyjet, parku nacional, ne si komunë kompetencat e vetme që i kemi pasur me i kontrolluar, me i skanuar gjendjen, me ia dërguar ministrisë sektorit të pylltarisë, kjo është bërë menjëherë dhe shumë shpesh, por degradimin nuk kemi mundur me ndal. Të pjesa që ka qenë në menaxhim të komunës, ka qenë shumë me e kontrolluar, por i ka kaluar në kompetencë ministrisë. Nëse jeni në dijeni, çdo sektor është duke shkuar drejt centralizimit, si inspektorati etj. Sa me tepër që centralizohen shërbimet, mungesa e kontrollit ka me qenë me e vështirë.

z. Jeton Luma: Deri diku pajtohem me ju kryetar. Unë kaloj nga ajo pjesë, pjesa e Sharrit është pjesa me e bukur e komunës tonë dhe me vitale. Unë si qytetar i kësaj komune jam për me lobuar. Pas lufte një pjesë të madhe të kohës kompetencat kanë qenë në menaxhimin e komunës, tani janë centralizuar, tani i kanë kaluar parkut kombëtar. Unë mendoj se kontributi duhet me qenë i përbashkët, nëse janë dëmtuar dhe janë duke u dëmtuar, tani ka

me u bërë edhe rikonstruimi i rrugës, po dëmtohet rruga edhe pjesa e pyjeve, kjo po ndikon në rrjedhjen e ujërave dhe në sigurinë e qytetarëve. Unë mendoj se këtu duhet me pasur një kontribut të përbashkët përtej dallimeve politike, se është aset i yni dhe mendoj se duhet me i shtyrë përpara ju si komunë dhe ne si anëtarë të KK, pavarësisht subjektit që i takojmë, se janë çështje jetike për komunën tonë.

znj. Kadrije Lika Troni: Për qentë endacak, a kemi ende kontratë me kompaninë e cila ka bërë identifikimin, kastrimin dhe vaksinimin e qenve endacak, nëse nuk gabojë kjo ka qenë diku në Gërllicë?

znj. Ernesta Krasniqi: Të çështja e kamerave të sigurisë, që e potencoj kryetari se dihet botërisht se kujt i takojnë. Kryetar, në mandatin e kaluar keni qenë këtu prezentë, kemi pasur debate të shumta se kujt i takojnë kompetencat, mirëpo kjo nuk është e rëndësishme të diskutohet sot, por është me rëndësi lajmi që është në proces për me bërë zgjidhje për to.

Kryetari i Komunës: Për qentë endacak, për momentin kontratë nuk kemi se i ka skaduar afati, tani është në procedurë e sipër. Kompetenca për kamerat e sigurisë është e atyre që i monitorojnë. Për derisa dikush e monitoron një aset, normal se është në kompetencë të tyre edhe nëse prishet. Meqë nuk ka pasur mundësi prej tyre me u bërë, e kemi gjetur një formë për me i dhënë fund kësaj çështje. Pse nuk ka hyrë në planifikim, e dinë edhe KKSB se jemi duke u munduar me bërë diçka në këtë aspekt. Të qentë endacak, e marrë obligim, se kjo është çështje që me së tepërmi është diskutuar në KKSB, ndërkaq zgjidhje nuk po ka.

znj. Ernesta Krasniqi: Çështja e kamerave të sigurisë është në proces, por nuk e di se a keni me bërë shtimin e kamerave, apo vetëm funksionalizimin e tyre? Nëse shtohen kamera të reja të sigurisë, i diskutoni në KKSB, se në cilat zona do të vendosen? Çështja e kamerave të sigurisë dhe çështja e qenve endacak, mendoj se janë të rëndësishme me u futur në planin e KKSB, se nuk janë të përfshira në këtë plan.

Kryetari i Komunës: Nuk e kemi diskutuar ende këtë temë, mendoj se do ti vejmë në funksion dhe do të shtojmë në terrene ku e vlerëson policia duhet me pasur kamera, do të shtohet numri i tyre.

Kryesuesi i Kuvendit: Me kërkesat që dolën që në planin e punës të hynë, çështja e kamerave të sigurisë dhe çështja e qenve endacak, u shtrua në votim për aprovim plani i KKSB dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 21. Konstatohet se Kuvendi i Komunës mori

VENDIM

Për Aprovimin e Planit të punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2026/ Lënda: 01Nr. 104/02-6030/26.

10. Propozim Vendimi për Ndryshim Plotësimin e Vendimit 01Nr. 104/02-4631/26 për shpalljen në interes publik të Parcelave kadastrale në ZK Kaçanik dhe ZK Bob, sipas kërkesës së ministrisë së linjës.

Kryesuesi i Kuvendit: Para se me hapur diskutimin, fjalën e ka drejtori i DUKMM, Korab Krasniqi.

z. Korab Krasniqi: Pas pranimit të aktit të vlerësimit nga MAPL 19.03.2026 për shqyrtimin e ligjshmërisë, Kryetari i komunës përmes DUKMM kërkon nga KK të merr vendim për ndryshim plotësim të Vendimit 01Nr. 104/02-4631/26 për shpalljen në interes publik të Parcelave kadastrale në ZK Kaçanik dhe ZK Bob. Në plotësim ndryshim janë dhënë sqarime shtesë për interesin publik të komunës dhe është kërkuar me u riformulua

mënyra e Propozim Vendimit për shpallje interesi. Lënda është e njëjtë, vetëm se ka sqarime shtesë në arsyetim.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Jeton Luma: Mendoj se ka ndryshim sa e ka vërejtur unë. Herën e kaluar ka qenë një fjalë që unë e kam bërë replikë, ka të bëjë me bonusin. Kërkoj sqarim për këtë, se lënda po duhet me u shqyrtuar dy herë.

z. Korab Krasniqi: Pasi është hequr çështja e bonusit, mendoj duhet me votuar këtë pikë.

z. Jeton Luma: Përse herën e parë ka qenë ajo fjalë, me provuar a po kalon në ministri.

z. Betim Shala: Është e vërtetë se DUKMM e ka bërë një lëshim të vogël. Duhet të kuptojmë saktë pse është kthyer çështja dhe të mos i japim kah tjetër. Sipas Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 1 të Protokollit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e drejta e pronës është e garantuar dhe askush nuk mund të privohet në mënyrë arbitrare. Në këtë rast, nuk kemi privim të pronës. Vendimi është kthyer në rishqyrtim, sepse mënyra e përcaktimit të kompensimit nuk ka garantuar vlerën reale të pronës dhe ka kufizuar të drejtën për kompensim financiar. Ligji nuk e ndalon bonusin ndërtimor, por kërkon që të mos cenohet e drejta për kompensim të drejtë. Problemi kryesor është se nuk është kërkuar me shkrim nga palët heqja dorë nga kompensimi financiar. Kjo procedurë është e nevojshme për mbrojtjen e tyre. Edhe pse palët në këtë rast preferojnë kompensim me bonus ndërtimor, heqja dorë nga kompensimi financiar duhet të jetë e dokumentuar. Vendimi nuk mund të anashkalojë ligjin për shpronësimin dhe as të kufizojë të drejtën për kompensim financiar. Prandaj, është dashur të sigurohet deklarim me shkrim nga palët. Sa i përket bonusit ndërtimor, ai lejohet sipas lëndës 0062610 të vitit 2021 PPI numër 6/2023 të 30.12.2024, ku komuna mund të zgjedhë formën më të favorshme të kompensimit.

z. Jeton Luma: Z. Betim, ju e keni çështjen me të qartë se jeni të fushës, unë nuk jam i fushës, ndërkaq me qartësi të kristalta që keni ndaj kësaj, pse nuk erdhi lënda herën e parë e rregulluar, pa qenë e potencuar pjesa e bonusit?

z. Betim Shala: Pse nuk ka ardhur në atë formë, mundet me sqaruar drejtori. Unë nuk e di kur është bërë apo si është bërë, unë vetëm e tregova formën ligjore qysh unë e kuptoj. Unë po e potencoj atë që po shkruan, e mos ti japim kahe tjetër. Unë e shpjegova për çka është kthyer, për shkak se mendohet se është privuar pala nga e drejta e kompensimit financiar, se nuk ka ekzistuar dokumenti që palët heqin dorë nga kompensimi financiar.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 15 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 6 anëtarët nga LVV. Prezentë 21. Konstatohet se Kuvendi i Komunës mori

VENDIM

Për Ndryshim Plotësimin e Vendimit 01Nr. 104/02-4631/26 për shpalljen në interes publik të Parcelave kadastrale në ZK Kaçanik dhe ZK Bob /Lënda: 01Nr. 104/02-6795/26.

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora 13:42. Deri në fund të mbledhjes ishin 21 anëtarët-të gjithë.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Kryesues i Kuvendit
Selajdin Troni



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/ Municipality of Kačanik
Zyra e Kryetarit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data 17.04.2026	Vendi Kačanik
Nj. org.	Numri	Shtojcë
	01-400/01-8999/26	

REFERENCË	
DATË	17.04.2026
PËR/ZA/TO:	Selajdin Troni- Kryesues i Kuvendit Komunal Zyra e Kuvendit Komunal Kačanik
CC:	Arton Ahmeti- Sekretar i Përgjithshëm Ministria e Financave
PËRMES/PREKO/THROUGH	Valdrin Dogani- Drejtor për Buxhet dhe Financa Gafurr Loku- Zyrtar Kryesor Financiar Komuna e Kačanikut
NGA/OD/FROM:	Sabedin Vishi- Zyrtar Kryesor Administrativ Kryetar i Komunës së Kačanikut
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Dorëzimi i Raportit Tremujor Financiar për periudhën 01.01.2026 - 31.03.2026

I nderuar,

Në mbështetje të nenit 45, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, po ju dorëzojmë Raportin Tremujor Financiar të Komunës së Kačanikut për periudhën 01.01.2026 - 31.03.2026, me qëllim të shqyrtimit të tij nga Kuvendi Komunal.

Raporti i bashkëngjitur përmban të dhënat lidhur me realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, investimet, si dhe përmbledhjen e statusit të projekteve kapitale të shpenzimit për tremujorin e parë të vitit fiskal 2026, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Ju lutem që ky raport të procedohet për shqyrtim në Kuvendin Komunal, ndërsa njëkohësisht kopja e tij po i përcillet edhe Ministrisë së Financave, sipas obligimit ligjor.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik/ Municipality of Kaçanik
Zyra e Kryetarit



REFERENCË	
DATË	17.04.2026
PËR/ZA/TO:	Selajdin Troni- Kryesues i Kuvendit Komunal Zyra e Kuvendit Komunal Kaçanik
CC:	Arton Ahmeti- Sekretar i Përgjithshëm Ministria e Financave
PËRMES/PREKO/THROUGH	Valdrin Dogani- Drejtor për Buxhet dhe Financa Gafurr Loku- Zyrtar Kryesor Financiar Komuna e Kaçanikut
NGA/OD/FROM:	Sabedin Vishi- Zyrtar Kryesor Administrativ Kryetar i Komunës së Kaçanikut
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Dorëzimi i Raportit Tremujor Financiar për periudhën 01.01.2026 - 31.03.2026

I nderuar,

Në mbështetje të nenit 45, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, po ju dorëzojmë Raportin Tremujor Financiar të Komunës së Kaçanikut për periudhën 01.01.2026 - 31.03.2026, me qëllim të shqyrtimit të tij nga Kuvendi Komunal.

Raporti i bashkëngjitur përmban të dhënat lidhur me realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, investimet, si dhe përmbledhjen e statusit të projekteve kapitale të shpenzimit për tremujorin e parë të vitit fiskal 2026, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Ju lutem që ky raport të procedohet për shqyrtim në Kuvendin Komunal, ndërsa njëkohësisht kopja e tij po i përcillet edhe Ministrisë së Financave, sipas obligimit ligjor.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK – MUNICIPALITY OF KAČANIK



RAPORTI TREMUJOR FINANCIAR

TM1 2026

Për periudhën 01 Janar 2026 – 31 Mars 2026

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Kaçanik, Prill 2026

I. Hyrje

Raporti Tremujor Financiar për periudhën **01 Janar 2026 – 31 Mars 2026** është përgatitur me qëllim të paraqitjes së ecurisë së realizimit të buxhetit të Komunës së Kaçanikut gjatë tremujorit të parë të vitit fiskal 2026.

Ky raport paraqet në mënyrë të përmbledhur dhe të qartë:

- realizimin e të hyrave,
- realizimin e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike,
- realizimin e shpenzimeve sipas programeve buxhetore,
- gjendjen e investimeve dhe
- statusin e projekteve kapitale të komunës.

Raporti është hartuar mbi bazën e të dhënave nga Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK) si dhe të dhënat plotësuese të siguruar nga drejtoritë dhe zyrat përkatëse komunale.

II. Baza ligjore

Ky raport është përgatitur në pajtim me [Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë](#), përkatësisht me **nenin 45**, sipas të cilit Kryetari i Komunës obligohet të përgatisë dhe t'i dorëzojë Kuvendit Komunal raportet tremujore financiare, si dhe një kopje t'ia dorëzojë ministrisë përkatëse brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të çdo tremujori.

III. Qëllimi i raportit

Qëllimi i këtij raporti është të informojë Kuvendin Komunal lidhur me:

- nivelin e realizimit të të hyrave dhe shpenzimeve gjatë TM1 2026;
- ecurinë e realizimit të buxhetit sipas kategorive ekonomike dhe programeve buxhetore;
- faktorët që kanë ndikuar në realizimin buxhetor gjatë kësaj periudhe;
- si dhe gjendjen e investimeve dhe projekteve kapitale.

IV. Organizimi i programeve buxhetore sipas drejtorive dhe zyrave

Për qëllime të paraqitjes së qartë të realizimit buxhetor, të hyrat dhe shpenzimet në këtë raport janë të organizuara sipas 19 programeve buxhetore që u përkasin drejtorive dhe zyrave përkatëse, si në vijim:

- Zyra e Kryetarit (16028 – Zyra e Kryetarit)
- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme (16328 – Administrata)
- Zyra për Barazi Gjinore (16528 – Çështje Gjinore)
- Zyra e Kuvendit (16928 – Zyra e Kuvendit Komunal)
- Drejtoria e Buxhetit dhe Financave (17528 – Buxheti)
- Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës (18028 – Shërbime Publike – Infrastruktura Rrugore dhe 18432 – Zjarrfikësit dhe Inspektimet)
- Zyra për Komunitete dhe Kthim (19640 – Zyra Lokale e Komuniteteve)
- Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë (47028 – Bujqësia)
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit (48028 – Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik)
- Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit (66445 – Planifikimi Urbanizmi Inspeksioni)
- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (73037 – Administrata (Sh), 74700 – Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor dhe 75636 – Shërbimet Sociale)
- Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (85028 – Shërbimet Kulturore)
- Drejtoria e Arsimit (92140 – Administrata (A), 92750 – Arsimi Parafillor / Çerdhet, 93810 – Arsimi Fillor dhe 95010 – Arsimi i Mesëm)

V. Përmbledhje ekzekutive

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2026, realizimi i buxhetit të Komunës së Kaçanikut është zhvilluar në rrethana specifike, për shkak se [Ligji Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026](#) ka hyrë në fuqi më 02 mars 2026. Deri në funksionalizimin e alokimeve buxhetore, komuna ka operuar pothuajse deri në fund të muajit mars sipas regjimit 1/12 të buxhetit të vitit paraprak, përkatësisht për muajt janar, shkurt dhe mars. Kjo ka ndikuar në alokimin e mjeteve, në ofrimin e zotimeve financiare dhe në fillimin më të ngadalshëm të realizimit, sidomos në kategorinë e investimeve kapitale. Pavarësisht kësaj, komuna ka vazhduar përmbushjen e obligimeve buxhetore dhe ka ruajtur funksionimin e rregullt financiar.

Përmbledhje e raportimit TM1 2026

Përshkrimi	Buxheti 2026 (€)	Buxheti final 2026 (€)	Shpenzimet TM1 2026 (€)	Variance ndaj buxhetit (€)= Buxheti final 2026- Shpenzimet TM 1 2026	Ekzekutimi (%)= Shpenzimet TM 1 2026/ Buxheti final 2026	Shpenzimet TM1 2025 (€)	Dallimi TM1 2026/2025 (€)	Dallimi TM1 2026/2025 (%)
1. Granti i Përgjithshëm	5,886,269.00	5,886,269.00	1,070,382.44	4,815,886.56	18.18%	816,958.18	253,424.26	31.02%
2. Granti specifik për Arsim parauniversitar	4,761,842.00	4,761,842.00	1,766,313.32	2,995,528.68	37.09%	1,489,890.10	276,423.22	18.55%
3. Granti specifik për Shëndetësi primare	1,686,509.00	1,686,509.00	449,708.77	1,236,800.23	26.67%	316,128.02	133,580.75	42.26%
I. Gjithsej GRANTI QEVERITAR (GQ= 1+2+3)	12,334,620.00	12,334,620.00	3,286,404.53	9,048,215.47	26.64%	2,622,976.30	663,428.23	25.29%
4. Të Hyrat Vetanake	1,065,133.00	1,065,133.00	-	1,065,133.00		-	-	
5. Të Hyrat Vetanake nga viti i kaluar	-	-	-	-		-	-	
II. Gjithsej TË HYRA VETANAKE (THV= 4+5)	1,065,133.00	1,065,133.00	-	1,065,133.00		-	-	
6. Partecipimet	-	160.85	-	160.85		-	-	
7. Donacionet	-	2,400.00	-	2,400.00		-	-	
II. Gjithsej PARTICIPIME dhe DONACIONE (GPD= 6+7)	-	2,560.85	-	2,560.85		-	-	
Gjithsej (I+II+III)	13,399,753.00	13,402,313.85	3,286,404.53	10,115,909.32		2,622,976.30	663,428.23	25.29%

Buxheti i aprovuar i Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2026 është në shumë prej 13,399,753.00 euro.

Ky buxhet përbëhet nga granti i përgjithshëm në shumë prej 5,886,269.00 euro, granti specifik për arsim parauniversitar në shumë prej 4,761,842.00 euro dhe granti specifik për shëndetësi primare në shumë prej 1,686,509.00 euro.

Nga këto burime, gjithsej granti qeveritar arrin vlerën prej 12,334,620.00 euro, që përfaqëson 92.05% të buxhetit total. Ndërkaq, të hyrat vetanake janë planifikuar në shumë prej 1,065,133.00 euro, që përbëjnë 7.95% të buxhetit total.

VI. Raporti mbi të hyrat

Në këtë kapitull paraqitet realizimi i të hyrave për periudhën **01 Janar 2026 – 31 Mars 2026**, duke përfshirë të hyrat vetanake sipas të dhënave të evidentuara në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK) dhe raportet përkatëse.

Të dhënat e paraqitura reflektojnë nivelin e realizimit të të hyrave gjatë tremujorit të parë të vitit 2026. Struktura e të hyrave pasqyron burimet kryesore të financimit të komunës, ndërsa niveli i realizimit është ndikuar edhe nga dinamika e zbatimit të dispozitave ligjore dhe procedurave administrative që kanë shoqëruar fillimin e vitit fiskal.

Raporti i të hyrave vetanake TM1 2026

Emërtimi i të hyrave vetanake	Planifikimi 2026 (€)	Realizimi TM1 2026 (€)	Realizimi (%)	Realizimi TM1 2025 (€)	Dallimi TM1 2026/2025 (€)
Të Hyrat Vetanake (I+II)	1,065,133.00	199,086.48	18.69%	184,125.62	14,960.86
1. Tatimi në pronë - Gjithsej	478,502.00	29,745.78	6.22%	46,473.07	(16,727.29)
Tatimi në tokë (parcelat)	93,925.00	-	-	-	-
Tatimi në pronë (objektet)	384,577.00	29,745.78	7.73%	46,473.07	(16,727.29)
2. Taksat komunale - Gjithsej	456,631.00	73,068.87	16.00%	64,636.03	8,432.84
Licencat dhe lejet	20,000.00	510.00	2.55%	7,000.00	(6,490.00)
Certifikatat dhe dokumentet zyrtare	24,000.00	6,830.10	28.46%	3,645.00	3,185.10
Taksat e pajisjeve motorike	71,000.00	20,780.00	29.27%	18,465.00	2,315.00
Lejet për ndërtesa	309,631.00	19,082.03	6.16%	2,021.68	17,060.35
Taksat tjera komunale	32,000.00	25,866.74	80.83%	33,504.35	(7,637.61)
3. Ngarkesat komunale - Gjithsej	120,000.00	17,450.72	14.54%	18,808.52	(1,357.80)
Ngarkesat rregullatore	10,000.00	515.00	5.15%	505.00	10.00
Të hyrat nga qiraja	15,000.00	1,021.72	6.81%	2,286.52	(1,264.80)
Bashkë-pagesat për arsim	40,000.00	15,564.00	38.91%	13,012.00	2,552.00
Bashkë-pagesat për shëndetësi	5,000.00	-	-	2,605.00	(2,605.00)
Ngarkesat tjera komunale	50,000.00	350.00	0.70%	400.00	(50.00)
4. Të hyrat tjera - Gjithsej	10,000.00	-	0.00%	5,763.00	(5,763.00)
Të hyrat tjera	10,000.00	-	-	5,763.00	(5,763.00)
I. Të Hyrat Direkte (1+2+3+4)	1,065,133.00	120,265.37		135,680.62	(15,415.25)
5. Policia e Kosovës (gjobat në trafik)	-	52,355.00		45,330.00	7,025.00
6. Gjykatat (gjobat)	-	9,150.00		3,115.00	6,035.00
7. Agjencioni i Pyjeve (taksat)	-	17,316.11			17,316.11
II. Të Hyrat Indirekte (5+6+7)		78,821.11		48,445.00	30,376.11

VI.1 Të hyrat vetanake sipas programeve buxhetore

Për një pasqyrë më të qartë të realizimit të të hyrave vetanake, në vijim paraqitet shpërndarja e tyre sipas programeve buxhetore dhe drejtorive përkatëse.

Inkasimet sipas programeve buxhetore (SIMFK) TM1 2026

Programi buxhetor	Kodi	Përshkrimi	TM1 2026 (€)	TM1 2025 (€)	Dallimi TM1 2026/2025 (€)
16328 - Administrata			6,830.10	9,408.00	(2,577.90)
	50013	Taksa për certifikatë të lindjes	2,969.00	2,877.00	92.00
	50014	Taksa për certifikatë të kurorëzimit	483.00	391.00	92.00
	50015	Taksa për certifikatë të vdekjes	106.00	57.00	49.00
	50016	Taksa për certifikata të tjera	3,055.10	313.00	2,742.10
	50017	Taksa për verifikimin e dokumenteve të ndryshme	7.00	7.00	-
	50025	Taksa për shtetësi	210.00	-	210.00
17528 - Buxheti			50,551.78	72,923.67	(22,371.89)
	40110	Tatimi në pronë	29,745.78	46,473.07	(16,727.29)
	50001	Taksa për regjistrim të automjeteve	20,780.00	18,465.00	2,315.00
	50019	Taksa të tjera administrative	26.00	7,985.60	(7,959.60)
18028 - Shërbime Publike - Infrastruktura Rrugore			3,809.00	5,770.00	(1,961.00)
	50008	Taksa për parkim publik, kamping dhe rekreacion	2,544.00	4,506.00	(1,962.00)
	50019	Taksa të tjera administrative	400.00	615.00	(215.00)
	50104	Gjobat nga inspektorati	350.00	120.00	230.00
	50405	Shfrytëzimi i pronës publike	515.00	505.00	10.00
	50407	Qiraja nga vendosja e objekteve tregtare	-	24.00	(24.00)
47028 - Bujqësia			10,049.94	3,375.75	6,674.19
	50012	Taksa për ndërrim të destinimit të pronës	8,603.80	2,210.75	6,393.05
	50019	Taksa të tjera administrative	1,446.14	885.00	561.14
	50424	Pranimet nga tarifimet për vendimet gjyqësore/përmbarim	-	280.00	(280.00)
66445 - Planifikimi Urbanizimi Inspekcioni			31,394.55	22,817.00	8,577.55
	50009	Taksa për leje ndërtimi	12,654.14	1,012.77	11,641.37
	50019	Taksa të tjera administrative	3,414.80	7,676.30	(4,261.50)
	50026	Taksa për legalizimin e objekteve	6,427.89	1,008.91	5,418.98
	50032	Taksa për certifikatë të pronësisë dhe kopje plani	6,343.00	1,706.50	4,636.50
	50045	Taksa për leje mjedisore	510.00	7,000.00	(6,490.00)
	50408	Qiraja nga prona publike	1,021.72	2,262.52	(1,240.80)
	50460	Taksa për regjistrim të pengut	280.00	340.00	(60.00)
	50504	Matja e tokës në terren	743.00	1,810.00	(1,067.00)
74700 - Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor			2,066.00	8,374.20	(6,308.20)
	50019	Taksa të tjera administrative	461.00	4,209.20	(3,748.20)
	50024	Taksa për certifikatë mjekësore	1,605.00	1,560.00	45.00
	50409	Participimet	-	2,605.00	(2,605.00)
92140 - Administrata			-	58.00	(58.00)
	50409	Participimet	-	58.00	(58.00)
92750 - Arsimi Parafillor / Çerdhet			15,564.00	12,954.00	2,610.00
	50409	Participimet	15,564.00	12,954.00	2,610.00
Të Hyrat Vetanake			120,265.37	135,680.62	(15,415.25)

VI.2 Sqarime lidhur me realizimin e të hyrave nga tatimi në pronë

Realizimi i të hyrave vetanake gjatë TM1 2026 është ndikuar edhe nga dinamika e faturimit të tatimit në pronë për vitin 2026.

Ligji mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2026 ka përcaktuar se zbatimi i shkallës progresive për tatimin në pronën e paluajtshme shtyhet dhe fillon së aplikuari nga viti tatimor 2027, ndërsa për vitin tatimor 2026 vazhdon të aplikohet shkalla tatimore tranzitore.

Si rezultat, deri më 31.03.2026 nuk kanë qenë aktive ngarkesat (faturat) për vitin tatimor 2026. Për këtë arsye, një numër i konsiderueshëm i qytetarëve, ndonëse të interesuar për pagesë, nuk kanë pasur mundësi të kryejnë obligimet e tyre para gjenerimit të faturave përkatëse, pasi nuk është ditur shuma për pagesë. Faturat për vitin 2026 kanë filluar të gjenerohen nga data 01.04.2026, çka pritet të reflektohet në TM2 dhe TM3 (rritje e inkasimit).

VII. Raporti mbi shpenzimet

Në këtë kapitull paraqitet realizimi i shpenzimeve të Komunës së Kaçanikut për periudhën **01 Janar 2026 – 31 Mars 2026**, sipas kategorive ekonomike dhe programeve buxhetore.

Shpenzimet sipas kategorive ekonomike - TM1 2026

Nr.	Kodi dhe kategoria ekonomike	Buxheti 2026 (€)	Shpenzimet TM1 2026 (€)	Shpenzimet TM1 2025 (€)	Realizimi përballë Buxhetit aktual 2026 (€)	Buxheti 2026 - Shpenzimet TM1 2026 (€)	Dallimi TM1 2026/2025 (€)	Dallimi TM1 2026/2025 (%)
1	11 Paga dhe Shtesa	7,883,305.00	2,490,755.42	1,798,474.94	31.60%	5,392,549.58	692,280.48	38.49%
2	13 Mallra dhe Shërbime	1,469,980.00	209,425.28	266,674.28	14.25%	1,260,554.72	(57,249.00)	-21.47%
3	14 Shpenzime komunale	225,000.00	72,145.58	37,456.36	32.06%	152,854.42	34,689.22	92.61%
4	20 Subvencione dhe Transfere	614,157.00	62,741.00	42,182.00	10.22%	551,416.00	20,559.00	48.74%
5	30 Investime kapitale / Pasuritë jofinanciare	3,207,311.00	451,337.25	478,188.72	14.07%	2,755,973.75	(26,851.47)	-5.62%
6	30 Rezerva	-	-	-	-	-	-	-
	Gjithsej	13,399,753.00	3,286,404.53	2,622,976.30	24.53%	10,113,348.47	663,428.23	25.29%

Realizimi i shpenzimeve gjatë TM1 2026 pasqyron funksionimin e rregullt të aktiviteteve komunale, ndonëse dinamika e shpenzimit është ndikuar nga hyrja me vonesë në fuqi e ligjit buxhetor për vitin 2026 dhe nga zbatimi i përkohshëm i regjimit financiar në fillim të vitit.

VIII. Shpenzimet sipas programeve buxhetore

Në vijim paraqitet realizimi i shpenzimeve sipas programeve buxhetore, në përputhje me strukturën organizative dhe funksionale të komunës. Kjo pasqyrë mundëson vlerësimin e shpërndarjes së shpenzimeve sipas drejtorive dhe zyrave komunale, si dhe identifikimin e programeve me realizimin më të lartë dhe më të ulët gjatë TM1 2026.

Shpenzimet sipas programeve buxhetore - TM1 2026

